

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5766
E enjte, 2 maj 2019
çmimi 0.40 €

Lëshohet në qarkullim
linja e autobusit
Prishtinë - ANP
'Adem Jashari' | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

SOVRANI T'I
LARGOJË NGA
QEVERISJA
FILISTINËT E
NARCISTËT F.8

Hasan MUJAJ



KOSOVA DHE
EVROPA F.11

Prof. ass. dr. Sabri
KIÇMARI



VESELI NË GLLOGJAN:
AMANETI I DËSHMORËVE
NUK NA LË TË LËVIZIM ASNJË
HAP PRAPA F.7

KONGRESI AMERIKAN KËRKON
DREJTËSI PËR KRIMET SERBE
NË KOSOVË F.2

EKONOMI



PËR 1 MAJ PUNËTORËT
KËRKUAN TË DREJTAT E VETA F.9

KULTURË

Bisedë me Milan KUNDERËN

KULTURËS I
DUHEN KUFIJTË
E HAPUR F.14-15

Bisedoi: Olga CARLISLE



SPORT

FERONIKELI - TREPÇA '89,
FINALJA E KUPËS F.18

FLET PËR "EPOKËN E RE", REXHEP HOTI | FAQE 4-5

Bashkimi i faktorit politik, i domosdoshëm



Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rexhep Hoti, ka thënë se skena politike në Kosovë tash e një kohë të gjatë është një përzjerje e motit të paparashikuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur për zgjedhjet në PDK, për koalicionin qeverisës dhe për Programin Nacional për Rininë, ku mban postin e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport. Hoti ka theksuar se

PDK-së i duhet një zgjim i madh. Ndërsa sa i përket taksës ndaj Serbisë, ai ka thënë se taksë nuk duhet të hiqet. Hoti ka pohuar se unifikimi i faktorit politik në përpjesëtim me fuqinë elektorale është i domosdoshëm. Duke folur për Programin Nacional për Rininë, ai ka theksuar se ky program ka mbështetjen e fuqishme të të gjitha subjekteve politike, të pozitës, opozitës dhe të të gjitha komuniteteve

Thaçi thotë se pa ShBA-në nuk ka marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi

Marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë është e pamundur pa rolin vendimtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Kështu ka deklaruar presidenti Hashim Thaçi të mërkurën në një konferencë për medie, në të cilën ka folur për ecurinë e Samitit të Berlinit. Ai ka bërë me dije se në këtë takim nuk ka dalë asnjë ide e re për marrëveshjen përfundimtare në mes të dy vendeve por, sipas Thaçit, ka pasur vullnet mbështetës për mundësinë e arritjes së një marrëveshje të tillë. Ai ka



theksuar se Bashkimi Evropian (BE) është duke treguar dobësi dhe jounitet për çështjen e Ballkanit Perëndimor | FAQE 3



Kurti: Gratë e të rinjtë në përqindje dërrmuese janë pa një vend pune | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Të mbijetuarit e luftës në Kosovë i drejtohen Kongresit Amerikan

Kongresi Amerikan kërkon drejtësi për krimet serbe në Kosovë



E mbijetuara e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi-Goodman, dhe Ilir Bytyqi, të cilët janë vranë tre vëllezër në luftë, kanë dëshmuar të martën para Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Kongresit Amerikan. Anëtarët e Kongresit janë shokuar se si askush deri më tani nuk është dënuar për këto krime. Eliot Engel, drejtues i këtij komiteti, ka kërkuar drejtësi për këto viktime. Ndërkaq liderët institucionalë në Kosovë i kanë mbështetur dëshmitë e viktimave të luftës

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 MAJ - Viktima e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi-Goodman, ka dëshmuar të martën para Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Kongresit Amerikan tmerrin që e ka përjetuar nga forcat serbe. Në seancën e komitetit me temë "Viktimat e luftës në Kosovë, në kërkim të drejtësisë", gruaja e parë, e cila ka treguar publikisht se ka qenë viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, ka shpalosur historinë e saj të trishtë, ku si 16-vjeçare është sulmuar dhe dhunuar seksualisht. "Më 14 prill, kur isha 16 vjeçe, një polic hyri në shtëpinë tonë dhe po e kërkonte babanë dhe vëllezërit e mi. Unë isha me nënën time. Ata na kërkuan letërnjoftimet. Pasi që e pa letërnjoftimin tim, e mbajti dhe më tha të shkoj në stacionin policor të jap deklaratë për burrat e shtëpisë. Në atë moment axha e pyeti se 'pse po e merr vajzën', ndërkaq polici i tha mos lëvizni se do t'ju

vrasm. Nëna ime i tha 'më merrni mua', por ata i thanë jo se ajo është femijë dhe nuk është në gjendje të gënjejë se ku e ka babanë dhe vëllezërit", ka rrëfyer Krasniqi-Goodman, duke përlotur disa nga të pranishmit. "Polic i më mori dhe më dërgoi në një shtëpi dhe më hodhi në dysheme. Unë fillova të bërtas, ndërkaq ai filloi të më dhunojë. Isha nën tytën e pushkës. Më keq-trajtoi. Më dhunonte dhe humba vetëdijen. Kur më erdhi vetëdija i kërkova të më vriste, por ai më tha 'jo sepse kështu do të vuash më shumë'. Dhe pati të drejtë. Më kujtohet që e kishte dorën e plagosur dhe tha se po merrte hakmarrje nga unë meqë, sipas tij, e kishte plagosur UÇK-ja", duke shtuar se kjo nuk ka qenë hera e vetme që është dhunuar nga zyrtarë serbë para se këta të fundit ta kthenin në fshatin e saj. Ajo ka treguar se rastin e kishte lajmëruar në të gjitha instancat gjyqësore ndërkombëtare në Kosovë dhe askush nuk është dënuar deri më tani.

Edhe Ilir Bytyqi ka mbajtur fjalim në Kongresin Amerikan, në emër

të familjes së tij që humbi në luftë tre familjarë: Yllin, Agronin dhe Mehmet Bytyqin. Ai ka thënë se pret nga ky Kongres që të punojë për qartësimin e historisë, asaj që shteti i Serbisë ka bërë gjatë luftës në Kosovë. "Kam pasur vëllezërit e mi, një familje e lidhur, një për një. Pra, një për të gjithë. Kur e pamë se çfarë po ndodhë në Kosovë tmerrohem kur shihnim pamje që familjarët tanë po vriteshin dhe dëboheshin. Pamë se shqiptarët në Nju Jork ishin mbledhur dhe donin të luftonin. Vëllezërit e mi u vranë derisa po shkonin që të luftonin. Trupat e tyre u gjetën në Serbi me duar të lidhura dhe me vrma në kokë. U vranë vetëm pse ishin shqiptarë", ka thënë Ilir Bytyqi.

Në këtë seancë profesori amerikan i çështjeve juridike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Paul R. Williams, ka thënë se sa i përket Kosovës, ekziston një "hapësirë e llogaridhënies". "Pavarësisht prej përpjekjeve të Tribunalit për Krime në ish-Jugosllavi, përpjekjeve të UNMIK-ut dhe EULEX-it, ekziston një hapësirë dramatike e llogaridhënies për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit që janë kryer kundër popullatës në Kosovë... ndëshkimi selektiv i disa liderëve ushtarakë dhe atyre politikë nga regjimi serb është padyshim i vlefshëm, por jo edhe i mjaftueshëm", ka deklaruar Williamsi.

Para anëtareve të Kongresit ka folur edhe ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, e cila ka apeluar para Kongresit Amerikan që të arrihet drejtësia për gratë e dhunuara gjatë kohës së luftës në

Kosovë. Pas këtyre rrëfimeve është shprehur i shokuar Eliot Engel, drejtues i Komitetit për Punë të Jashtme në Kongresin Amerikan, se si askush nuk u dënua për krimet e kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë. "Beogradi është përgjegjës edhe për dhunimin e 20 mijë grave. Raporti i The Human Rights thotë se përdhunimet kanë qenë të pranishme në Kosovë dhe si armë e luftës për spastrim etnik. Përdhunimet nuk kanë qenë individuale, por mjete të qëllimshme për ta terrorizuar popullatën civile. Dhunimet ishin metodë për t'i përzënë shqiptarët nga Kosova. 20 vjet më pas pak është bërë që të vihet drejtësia. Asgjë nuk është bërë që të sigurohet drejtësi për viktimat", ka thënë Engel, duke shtuar se aleatët perëndimorë kanë mundur të bëjnë më shumë në këtë drejtim. "Nuk është arritur më shumë për drejtësi ndaj viktimave që kanë vuajtur nga ushtria e Slllobodan Millosheviqit. Ne mendojmë se aleatët kanë mundur të bëjnë më shumë për të sjellë drejtësi. Nuk është bërë asgjë ndaj serbëve që kanë bërë krime", është shprehur Engel. Liderët institucionalë të Kosovës e kanë përshëndetur dëshminë e viktimave të mbijetuara nga lufta para Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Kongresit Amerikan. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se institucionet e Kosovës urgjentisht duhet ta nxjerrin rezolutën për krimet dhe gjenocidin e Serbisë në Kosovë siç e ka propozuar edhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli. "Edhe pas 20 vjetësh askush nga urdhërdhënësit dhe ekzekutuesit e këtyre

krimeve, dhunimeve, masakrave, spastrimit etnik dhe veprimeve të tjera gjenocidale gjatë luftës së fundit në Kosovë nuk doli para drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare. Iniciativa e znj. Vasfije Krasniqi për ta thënë publikisht përjetimin tragjik është shprehje e guximit të saj të lartë qytetar, prandaj asnjë segment i krimit serb nuk bën të heshtet, sado i vonshëm që të bëhet ai krim", ka thënë Thaçi të mërkurën në një konferencë për medie, duke shtuar se pa mbështetjen e kongresistit Eliot Engel rrëfimi i Vasfijes do të ishte i pamundur.

Kryeparlamentari Kadri Veseli i ka dhënë mbështetje rrëfimit të Vasfije Krasniqit. "Vasfije Krasniqi-Goodman e tha edhe sot se është vetëm drejtësia ajo që do t'i shërojë vuajtjet dhe plagët e saj nga lufta. Në Komitetin për Politikë të Jashtme të Kongresit Amerikan ajo, Ilir Bytyqi dhe ish-presidentja Atifete Jahjaga dëshmuar për krimet makabre të pushtetit serb ndaj qytetarëve të Kosovës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se është i admirueshëm guximi i Vasfijes për të dëshmuar. "Dëshmitë e Vasfije Krasniqi-Goodman, Ilir Bytyqit dhe presidentes Jahjaga në Kongresin Amerikan janë zëri më i besueshëm i Kosovës për krimet monstruoze të Serbisë gjatë luftës në Kosovë. I admirueshëm guximi i Vasfijes, e cila u bë zëdhënëse e rreth 20 mijë femrave shqiptare, viktime të dhunës seksuale", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë me gazetarë, ku ka folur për Samitin e Berlinit

Thaçi thotë se pa ShBA-në nuk ka marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi

Marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë është e pamundur pa rolin vendimtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Kështu ka deklaruar presidenti Hashim Thaçi të mërkurën në një konferencë për medie, ku ka folur për ecurinë e Samitit të Berlinit. Ai ka bërë me dije se në këtë takim nuk ka dalë asnjë ide e re për marrëveshjen përfundimtare në mes të dy vendeve por, sipas Thaçit, ka pasur vullnet mbështetës për mundësinë e arritjes së një marrëveshje të tillë. Ai ka theksuar se Bashkimi Evropian (BE) është duke treguar dobësi dhe jo unitet për çështjen e Ballkanit Perëndimor. Sipas presidentit Thaçi, Kosova është prezantuar me qëndrim unik në Samitin e Berlinit

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 MAJ - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën ka mbajtur konferencë me gazetarë, në të cilën ka folur për zhvillimet e Samitit të Berlinit, me ç'rast ka bërë me dije se nga ky takim nuk ka pasur asgjë konkrete për arritjen e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Samiti i Berlinit ka qenë një mundësi e mirë dhe është në interes që ka ndodhur sepse është diskutuar për të gjitha çështjet e hapura dhe që mund të hapen. Por në këtë samit nuk ka dalë asnjë ide e re për marrëveshjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Pra, nuk ka pasur asgjë thelbësore apo diçka kreative që do të ndihmonte në përsheptimin e zgjidhjes në mes të Kosovës dhe Serbisë përpos vullnetit mbështetës për mundësinë e arritjes së një marrëveshje. Prandaj të gjitha alternativat janë të hapura për mundësinë e arritjes së një marrëveshje historike përfundimtare në mes të dy vendeve sovraane", ka deklaruar Thaçi.

Ai ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) është duke treguar dobësi dhe jo unitet për çështjen e Ballkanit Perëndimor. Prandaj, sipas presidentit Thaçi, pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ka marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi. "Bashkimi Evropian është duke

treguar dobësi dhe jounitet për çështjen e Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi është e pamundur pa rolin vendimtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", është shprehur Thaçi, duke shtuar se Kosova është prezantuar me qëndrim unik në Samitin e Berlinit.

Ai ka treguar se gjatë diskutimit në këtë samit e ka bërë të qartë përkushtimin e Kosovës për ta vazhduar dialogun pa kushtëzime. "Dialogu i filluar në vitin 2011, përkundër rezultateve të prekshme, tani është i bllokuar nga Serbia, e cila e ka kushtëzuar vazhdimin e tij me heqjen e takës. Kushtëzimi i dialogut nuk ka guxuar të ndodhë në asnjë rrethanë sepse dialogu nuk mund të kushtëzohet nga asnjëra palë. Ky ka qenë parimi udhëheqës i pashkruar që nga fillimi i këtij procesi", ka theksuar ai.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se nuk do të lejojë që në Kosovë të formohet një asociacion i komunave serbe, i cili do të kishte elemente ekzekutive. Sipas tij, qëllimi i Serbisë është që në veri të Kosovës, të formohet një asociacion i ngjashëm me modelin e Republikës Serbe. "Serbia ia ka pamundësuar Kosovës që ta zbatojë në praktikë marrëveshjen për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit të 2013-s dhe vendimit të Gjykatës së

Kosovës. E ritheksoj edhe një herë, se nuk do të ketë asnjë lloj asociacioni që mund të ketë ndonjë element ekzekutiv. Qëllimi i qartë i Serbisë me këtë angazhim është që në pjesën veriore të Kosovës të themelohet një Asociacion i Komunave Serbe me kompetenca ekzekutive, i njëjtë me modelin e Republikës Serbe. Një gjë e tillë nuk do të lejojë që të ndodhë", ka theksuar presidenti, duke shtuar se taksa ndaj produkteve serbe duhet të mbetet në fuqi.

Duke treguar për punimet e Samitit të Berlinit që u zhvillua të hënën, Thaçi ka thënë se perspektiva evropiane e Kosovës është vetëm frazë pasi, sipas tij, Bashkimi Evropian nuk ka bërë asgjë konkrete në këtë drejtim. "Procesi i integritetit në BE pothuajse është tërësisht i bllokuar. Perspektiva evropiane për Kosovën mbetet vetëm një frazë e mirë për veshët e cila vazhdon të përsëritet, por asgjë më shumë. Realiteti i sotëm në Ballkanin Perëndimor nuk përputhet aspak me pritjet tona dhe, ndoshta, edhe me ato të BE-së. Përkundër faktit që shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 i ka dhënë fund procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, paqja në rajonin tonë ende mbetet e brishtë. Jostabiliteti aktual në marrëdhëniet e Kosovës me shtetet fqinje në rajon së pari është rezultat i mosnjohjes dhe sjelljes armiqë-

sore të Serbisë dhe, së dyti, mosnjohja e pavarësisë nga Bosnja dhe Hercegovina. Serbia në mënyrë të vazhdueshme ka vazhduar ta cenojë dhe minojë sovranitetin shtetëror të Kosovës. Për çudi, sjellja armiqësore dhe anti evropiane nuk e ka frenuar rrugëtimin e Serbisë drejt anëtarësimit në BE", ka deklaruar Thaçi. Ai ka thënë se mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia po shkakton probleme të mëdha për rrugëtimin euroatlantik të Kosovës. "Kjo situatë ka mundësuar që pesë shtetet anëtare të BE-së, të mos e njohin ende Kosovën. Si rrjedhojë, legalisht dhe praktikisht Kosova e ka të pamundur të bëjë hapa konkretë për anëtarësim në BE dhe NATO. Si përfundim, marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë janë vazhdimisht të acaruar. Ekzistojnë barrierat shumë të shumta për lirinë e lëvizjes për qytetarët dhe mallrat", ka theksuar presidenti. Kurse sa i përket procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën, Thaçi ka thënë se BE-ja e ka mashtruar Kosovën. "Ratifikimi i demarkacionit (me Malin e Zi) ka qenë kriteri i fundit për liberalizimin e vizave, mirëpo e kam theksuar edhe në takim se realiteti i sotëm dëshmon se ky kriter ka qenë vetëm një mashtrim dhe asnjë më tepër, apo një premtim mashtrues. Kosova padrejtësisht mbetet vendi më i izoluar në Evropë për shkak të mosnjohjes evropiane", ka deklaruar Thaçi.



FLET PËR "EPOKËN E RE", REXHEP HOTI

Bashkimi i faktorit politik,



Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rexhep Hoti, ka thënë se skena politike në Kosovë tash e një kohë të gjatë është një përzierje e motit të paparashikuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur për zgjedhjet në PDK, për koalicionin qeverisës dhe për Programin Nacional për Rininë, ku mban postin e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport. Hoti ka theksuar se PDK-së i duhet një zgjim i madh. Ndërsa sa i përket taksës ndaj Serbisë, ai ka thënë se taksë nuk duhet të hiqet. Hoti ka pohuar se unifikimi i faktorit politik në përpjesëtim me fuqinë elektorale është i domosdoshëm. Duke folur për Programin Nacional për Rininë, ai ka theksuar se ky program ka mbështetjen e fuqishme të të gjitha subjekteve politike, të pozitës, opozitës dhe të të gjitha komuniteteve

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 MAJ -

"Epoka e re": Z. Hoti, si Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport keni nënshkruar disa marrëveshje me komuna rreth zbatimit të programit nacional për rininë. Cila është rëndësia e këtyre marrëveshjeve dhe programit në tërësi?

Hoti: Programi Nacional për Rininë është programi i vetëm kompleks në Republikën e Kosovës që ka mbështetje të fuqishme të të gjithë subjekteve politike të vendit qofshin ato opozitare apo në pushtet si dhe të të gjitha komuniteteve. Një konstatim i tillë peshon edhe më shumë nga e dhëna se programi në fjalë është bërë tashmë

pjesë e çdo kryetari të çdo komune në Republikën e Kosovës, çka do të thotë se një vendim i qeverisë qendrore është thelluar në bashkëpunim përtej përgjegjësisë dhe obligimeve elementare. Vendi ynë me këtë hap ka plotësuar edhe një zbrazëti kushtetuese dhe ligjore për të gjithë nxënësit pa përjashtim dhe pa dallime, të rreth 340 mijë sosh, të cilët kanë hapësirë për ta shfrytëzuar mundësinë e aktiviteteve të tyre kurrikulare e jashtë kurrikulare në tri shtyllat boshtore të Programit: në Dituri, në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik dhe në Sport.

"Epoka e re": Deri ku ka arritur zbatimi i programit nacional për rininë në nivel komunal, pasi janë mbajtur disa gara të

Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik në nivelin komunal?

Hoti: Më lejoni t'ju themi se nuk janë mbajtur disa gara, por janë mbajtur garat në Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik në të gjitha komunat e vendit në nivelin shkollor si dhe në nivelin komunal, me përjashtim të dytri komunave të cilat ende janë në proces të garave komunale për KKMK. Sipas të dhënave që i ka pranuar deri më tash Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport nga të gjitha shkollat e vendit, por që ende nuk janë të gjitha të përpunuara e të përfunduara, janë 14 902 vende të para të garave të nivelit shkollor të Kreativitetit Kulturor e të Mendimit Kritik në gjithë vendin. Kjo do të thotë se deri më tash kanë marrë pjesë

në gara të nivelit komunal rreth 15 000 fitues nga klasa e parë deri në klasën e 12-të. Është një mobilizim i jashtëzakonshëm i Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA), i shkollave, i nxënësve, i prindërve. Për herë të parë kam parë nga afër shtëpi të kulturës të përmbushura përplot me nxënës, shkolla me nga tri-katër ndërrime e hapësira për mbajtjen e garave. Kam parë DKA që është përgatitur për një muaj rresht për garat komunale. Kam parë rreshta të gjatë të nxënësve duke pritur për të hyrë në garë me dhjetëra e dhjetëra metra të gjata për ta performuar krijimin e vet. Pa teprim, mund të them se kjo është një mrekulli e vogël që po lind prej të gjithë aktorëve dhe prej vetë shpërthimit kreativ të nxënësve.

"Epoka e re": Çfarë mbështetje keni nga Qeveria e Kosovës në këtë drejtim?


Hoti: Qeveria e Kosovës e ka ofruar mbështetjen e plotë, sado që aspekti financiar i Programit Nacional për Rininë ende nuk e ka marrë mbështetjen për ta pasur arritshmërinë e vet, nëpërmjet së cilës do të mund të ishte funksionale në tërësinë e vet. Veçmas pjesa e aktivizimit të shtyllës së sportit

kërkon një angazhim shumë më të madh, sepse do të ketë nevojë për investime nëpër shkolla. Madje do të shikohet edhe infrastruktura e munguar sportive për shkollat të cilat kanë nevojë ta kenë të kompletuar infrastrukturën dhe hapësirën sportive, nga mjetet e zakonshme sportive e deri te fushat dhe hapësirat e tjera të nevojshme. Por, si fillim jemi të kënaqur me mbështetjen e qeverisë dhe të kryeministrit veçmas, ashtu sikurse me kryetarët e komunave, me DKA-të, me drejtorët e arsimit të shkollave, me stafin e mësimdhënësve, me MASHt-in, SBASHK-un e kështu me radhë.

"Epoka e re": Si Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport keni vizituar Shqipërinë, Luginën e Preshevës dhe Ulqinin. Sa ka rëndësi bashkërendimi i agjendës në këtë program me këto vende dhe cila ka qenë përkrhja që keni marrë?

Hoti: Bashkëpunimi i jashtëm i KNKRS-së është strategji në vete programore. Në këtë drejtim Programi Nacional për Rininë ka tri opsione të bashkëpunimit: bilateral, multilateral dhe mbarëkombëtar. Kemi hartuar

i domosdoshëm



gjithë nxënësit dhe studentët e këtyre shteteve. Me kryeministrin e Shqipërisë, Ministrinë e Arsimit e struktura të ministrisë së saj veçse e kemi shpalosur programin në pika të shkurtra. Është e kuptueshme se sistemi ynë konceptual i programit duhet ta ketë kohën e vet për ta arritur fuqinë e bashkëpunimit konkret. Kjo do të thotë se shumëçka do të varet prej vetë nesh e më pas do të kemi mundësi ta importojmë implementimin e filozofisë së konceptit dhe shtrirjen e saj në arsim edhe në vendet me të cilat kufizohemi. Kjo vlen për të tria rastet e bashkëpunimit ndër-shtetëror, qoftë të atij bilateral, multilateral apo mbarëkombëtar.

"Epoka e re": Programi Nacional për Rininë, çfarë mbështetje ofron për diasporën, sepse e dimë se ministrinë tona të Kulturës dhe Diasporës në Kosovë dhe në Shqipëri nuk kanë bërë edhe aq sa duhet për diasporën shqiptare, rininë në përgjithësi?

Hoti: Brenda programit është e integruar edhe diaspora shqiptare. Pavarësisht se ajo do ta ketë një mundësi më të lehtë të garimit, sepse në shtetet e jashtme mërgata do t'i përzgjedhë nxënësit. Ndërsa te ne vlen sistemi i gjithëpërfshirjes. Mirëpo më e rëndësishme sesa një favorizim rrethanor, të themi kushtimisht, është pjesëmarrja e diasporës në garat nacionale ndërshtetërore. Me kohë edhe në diasporë do të

kemi mundësi ta avancojmë sistemin e gjithëpërfshirjes për çka varet shumë nga qasja gjenerale e politikave nacionale për gjysmën e kombit që e kemi jashtë atdheut.

"Epoka e re": Z. Hoti, jeni edhe nënkryetar i PDK-së. Çfarë vlerësimi keni për punën e kësaj qeverie? A janë plotësuar pritjet e PDK-së për këtë periudhë të qeverisjes në bazë të marrëveshjes që keni me partnerët e tjerë të koalicionit?

Hoti: Për shkak të pragmatizmit politik të imponuar nga klima dhe niveli i zhvillimit tonë të gjithanshëm do të ishte më mirë të mos e shfaq fare mendimin në këtë pyetje. Nuk do ta vlerësoja aq me peshën atë që do ta thosha përballë asaj sa do të mund ta dëmtoj me një përgjigje të tillë.

"Epoka e re": A mendoni se PDK-ja karshi disa temave do të duhej të ishte më e zëshme brenda koalicionit qeverisës? Kemi parë punësime të shumta partiake, sidomos në Telekom, për çka ka pasur edhe kritika nga opozita, pastaj taksa 100 për qind ndaj produkteve serbe dhe kërkesa e ShBA-së për pezullimin e saj...

Hoti: Është e vërtetë se punësimet partiake, ku më shumë e ku më pak, janë pjesë e establishmentit politik të vendit. Mendoj se është krijuar një praktikë shume e keqe e punësimeve të tilla. Por, parë me realizëm, mendoj se kjo është kultura dhe niveli ynë në

politikë përballë pushtetit. Ndërsa sa i përket taksës, ajo nuk duhet të hiqet. E para, mendoj se duhet të merremi më shumë me argumentimin se një Kosovë e fuqishme në vendim-marrje shtetërore, duke e respektuar Kushtetutën, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, është një garanci e fuqishme për stabilitetin e saj përballë Serbisë dhe faktorit të jashtëm. E dyta, unifikimi i faktorit politik në përpjestim me fuqinë elektorale që ato kanë është i domosdoshëm. E treta, lidhja e Kosovës me ShBA-në nuk është lidhje e rëndomtë e as garë se kush mund ta ketë më mirë me amerikanët a kush i do më shumë ata. Kjo politikë e paditur, thënë me figurë, duhet të marrë fund. E katërta, 'mbidoza e autoriteteve' të disa ambasadorëve të shteteve partnere në vendin tonë është duke e dëmtuar klasën politike edhe ashtu të brishtë. Ndoshta konfidencialiteti i këshillës diplomatike duhet të rritet më shumë e politika e tyre e fejsbukizmit duhet të zvogëlohet dukshëm. Disa janë skandalizuar me prezantimin e tyre të shpeshtë. Duket sikur të tillët shkruajnë në "Facebook" sa për t'u bërë lajme portaleve. Si rrjedhojë, duket sikur edhe e kanë humbur peshën reale që ata duhet të kishin dhe e kanë.

"Epoka e re": Çfarë mund të na thoni për PDK-në, zgjedhjet e saj të brendshme dhe nominimin e Kadri Veselit për kryeministër nga disa zyrtarë të

PDK-së?

Hoti: PDK-së mendoj se i duhet një zgjim i madh. Më bëri përshtypje qëndrimi i nënkryetarit Kuçi kur e dëgjova që shprehu mendimin se nuk janë në PDK ata që flasin tash e një kohë në emër të saj. Do të pajtohesh me të. Do të doja që Kadri Veselin ta propozojë për kandidat për kryetar të partisë PDK-ja rrjedhimisht, më pas edhe për kryeministër, e jo të jetë i propozuar nga ata që marrin vetëm prej PDK-së tituj, kapitale, poste, shkolla e gjithçka tjetër e janë pak a hiç PDK. Vetë ngutja për ta shpallur Kadri Veselin kandidat për kryeministër ende pa u zgjedhur kryetar i partisë është një naivitet që tregon për nivelin kontrollues të demokracisë brenda partisë. Dmth., në mënyrë naive të tillët kanë treguar se nuk e zgjedh procesi zgjedhor Kadri Veselin për kryetar, por ai është 'apriori i tillë'. Kjo ngutje servile i bën dëm edhe Kadri Veselit, në të vërtetë, ai është duke u dëmtuar tash e një kohë të gjatë prej poltronëve të këtyllë por, në të njëjtën kohë, e dëmton rëndë edhe partinë, demokracinë e brendshme të saj e bën groteske. Sidoqoftë, pres një zgjim të madh. Mendoj, ende ka kohë. Pastaj PDK-ja ka një mandat kushtetues për të qeverisur dhe ajo duhet të sillet me standardin e një partie serioze, institucionale dhe demokratike, ashtu siç i ka themelet dhe përkufizimet e veta teorike e praktike.

edhe Programin Ndërshtetëror për tri vendet fqinje: Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Madje ua kemi kryer si draft edhe aspektin buxhetor për të

Fuqizohet bashkëpunimi Kosovë - Turqi në shëndetësi

PRISHTINË, 1 MAJ (ER) - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Naim Bardiqi, mori pjesë këto ditë në Kongresin e Dytë Ndërkombëtar të Mjekësisë Tradicionale dhe Komplementare (GETAT), i cili u mbajt në Stamboll të Turqisë nën përkujdesjen e Presidencës dhe zonjës së parë të shtetit të Turqisë dhe me asistencën teknike të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh-së).

Në këtë kongres, në të cilin marrin pjesë rreth dy mijë pjesëmarrës nga shtete të ndryshme, janë trajtuar aspekte të ndryshme të aplikimit të mjekësisë tradicionale dhe komplementare për trajtimin e sëmundjeve dhe problemeve të ndryshme në mjekësi si diabeti, obeziteti, sëmundjet kardiovaskulare, alergjitë, kanceri, dhimbja kronike, varshmëria, mjekësia tradicionale dhe komple-

mentare në neurologji e psikologji, në mjekësinë preventive etj.

Në këtë kongres është diskutuar edhe për Strategjinë në fuqi të OBSh-së për Mjekësinë tradicionale 2014-2023. Gjatë pjesëmarrjes në këtë kongres, sekretari Bardiqi ka takuar edhe Ministrinë e Shëndetësisë të Republikës së Turqisë, Fahrettin Koca, si dhe ka zhvilluar takime edhe me zëvendësimistren e Shëndetësisë të Turqisë, Emine Alp Mese, me të cilën janë trajtuar aspektet e bashkëpunimit në shëndetësi midis dy shteteve.

Në mbështetje të bashkëpunimit midis dy shteteve në shëndetësi që realizohet në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, do të jetë zëvendësimistria Emine Alp Mese ajo që do të udhëheqë një ekip prej rreth 30 ekspertëve të fushave mjekë-



sore, të cilët do të vijnë në muajt e ardhshëm në Kosovë, në kuadër të Javës së

Shëndetësisë Kosovare-Turke për ta përkrahur fuqizimin e shërbimeve ekzistuese shën-

detësore dhe hapjen e shërbimeve të reja shëndetësore në Kosovë.

Ambasadorët e BE-së informohen për masat e ndërmarra në luftën kundër terrorizmit

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 MAJ - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i shoqëruar nga Koordinatorin Nacional Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit, Fatos Makolli, ka zhvilluar një takim me ambasadorë dhe shefa të misioneve diplomatike të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilët i ka informuar për riadhesimin e 110 qytetarëve nga zonat e konfliktit në Siri.

Ministri Tahiri ka informuar ambasadorët për masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat kanë pamundësuar pjesëmarrjen e kosovarëve në organizatat terroriste, duke folur nga perspektiva e masave ligjore si dhe nga mobilizimi social. Sipas ministrit Tahiri, ndryshimet e bëra në legjislacionin penal sanksionuan çfarëdo pjesëmarrje në konflikte të huaja të motivuara nga doktrinat radikale si dhe përhapjen, mbështetjen dhe financimin e terrorizmit. "Trendit të pjesëmarrjes në konflikte të huaja, institucionet dhe shoqëria jonë i kanë dhënë një përgjigje të fuqishme, duke e bërë një ndarje të thellë nga çfarëdo motivimi, mbështetje apo sinergji për ngjarjen në Siri dhe Irak. Si rezultat e kësaj ndërmarësie, nga viti 2016 asnjë qytetar i vetëm i Republikës së



Kosovës nuk iu është bashkangitur konflikteve në zhvillim apo grupeve terroriste. Asnjë qytetar s'ka udhëtuar në zonat e konflikteve", ka thënë ministri Tahiri. Ministri Tahiri i ka njoftuar ambasadorët e BE-së për rolin e tij në drejtimin e Task Forcës për riadhesimin e shtetasve të Republikës së Kosovës nga zonat e luftës në Siri. "Si ministër i Drejtësisë kisha përgjegjësi ta adresoj edhe pikëpamjen se

Republika e Kosovës dhe Kushtetuta jonë nuk mund ta mohojnë të drejtën e ekzistencës dhe shtetësisë së qytetarëve tanë që ishin në Siri, veçmas atyre viktimave të mashtrimit dhe fëmijëve. Në vend të mohimit të ekzistencës së tyre, ne zgjedhëm të marrim pronësi të plotë mbi ta, përmes një vendimi të qartë: kriminelët para drejtësisë dhe viktimat në rehabilitim dhe risocializim", ka thënë ai.

Tahiri ka folur edhe për rolin e Republikës së Kosovës në kuadër të Aleancës Globale Kundër ISIS si një prej vendeve që prijnë në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. "Republika e Kosovës ka vendosmëri të plotë që parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit të mbetet një prej agjendave të rëndësishme për të cilat angazhohet shoqëria jonë dhe

institucionet tona. Nuk do të lejojmë në asnjë rrethanë që qytetarët tanë të paraqesin kërcënim për rendin tonë kushtetues dhe për vendet e tjera demokratike. Riadhesimi i qytetarëve tanë nga zonat e konfliktit në Siri dhe shpëtimet nga shfrytëzimi i tyre nga organizatat terroriste dhe grupet radikale është një goditje e fuqishme që Republika e Kosovës i ka dhënë terrorizmit", ka theksuar ministri Tahiri.

Lëshohet në qarkullim linja e autobusit Prishtinë - ANP 'Adem Jashari'



PRISHTINË, 1 MAJ (ER) - Të mërkurën është lëshuar për qarkullim linja e autobusit Prishtinë - ANP "Adem Jashari" dhe anasjelltas. Kjo linjë e nevojshme për të gjithë qytetarët që udhëtojnë përmes aeroportit të Prishtinës për të lëvizur drejt

Evropës dhe botës u materializua pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit nga ana e ministrit Pal Lekaj. Në këtë aktivitet, në emër të ministrit Lekaj, mori pjesë zëvendësministri Rexhep Kadriu, i cili theksoi rëndësinë e

kësaj linje të autobusit dhe në të njëjtën kohë shprehu angazhimin e ministrit dhe ministrisë për të mundësuar edhe një linjë të tramvajit që do ta mundësojë qarkullimin edhe më të shpejtë të qytetarëve nga kryeqyteti në drejtim të ANP



"Adem Jashari". Zëvendësministri Kadriu, po ashtu, theksoi angazhimin në të ardhmen që çmimi fillestar prej tre eurosh të zbritet, sepse kjo do të ndikonte edhe më tepër që kjo mënyrë e lëvizjes në këtë relacion të bëhet edhe më e përdor-

shme nga të gjithë. "Jemi të hapur që Komunës së Prishtinës t'i dalim në ndihmë edhe në sektorë të tjerë, ku do të ndikonim pozitivisht në jetën e qytetarëve dhe ekonominë e tyre", ka thënë zëvendësministri Rexhep Kadriu.

Në 20-vjetorin e rënies është përkujtuar të mërkurën dëshmori Agim Selmanaj

Veseli në Glogjan: Amaneti i dëshmorëve nuk na lë të lëvizim asnjë hap prapa

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë bërë homazhe të mërkurën në Glogjan të Deçanit në përkujtim të 20-vjetorit të rënies së dëshmorit Agim Selmanaj. Kryeparlamentari Veseli ka theksuar se amaneti i dëshmorëve nuk na lë të lëvizim asnjë hap prapa



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

DEÇAN, 1 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të mërkurën se amaneti i dëshmorëve nuk lejon që të bëhet asnjë hap prapa, por të ruhet shteti i pavarur e sovran i Kosovës, duke punuar edhe më shumë për zhvillimin dhe përparimin e tij.

Në kujtim të 20-vjetorit të rënies së dëshmorit Agim Selmanaj, kryeparlamentari Veseli ka thënë në Glogjan se vetëm disa javë para shënimit të 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës anekënd vendit po kujtohen dhe nderohen dhembja, sakrificat dhe të rënët në altar e lirisë. "Jemi sot këtu, në Glogjanin e lirisë, në Glogjanin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Glogjanin e Luanit, Shkëlzenit e

të dhjetëra dëshmorëve të tjerë, për të kujtuar një hero të Kosovës, një djalë të ri, Agim Selmanaj. Agimi nuk ishte më shumë se 20-vjeçar dhe në vend që t'i merrte mjetet e mësimnxënies, atij iu desh që t'i merrte në duar armët e lirisë. Sepse kjo ishte thirrja e atdheut. Në vend se ta gëzonte jetën, ai u desh ta jepte jetën për lirinë e Kosovës. Ky është çmimi i sakrificës sonë. Ky është çmimi i shtetit tonë", ka theksuar kryeparlamentari Veseli.

Ai ka shtuar se të gjallëve sot, kjo sakrificë, si amanet i këtyre njerëzve, dëshmorëve e të rënëve si Agimi, nuk i lë që për asnjë hap, për asnjë milimetër të lëvizim prapa. "Ta ruajmë këtë shtet të cilin e kemi sot dhe të punojmë edhe më shumë, duke e dashur atë, duke punuar ndershmërisht, duke punuar më shumë që ta

zhvillojmë, duke u dhënë mundësi bashkëmoshatarëve të Agimit, sot 20-vjeçar, të kenë perspektivë edhe më të mirë në shtetin e vet, në tokën e vet. Të gjithë bashkëluftëtarët duhet të ndihen krenarë me veprën e tyre

dhe të punojnë më shumë për vendin", ka deklaruar kryeparlamentari Veseli.

Ndërkaq i pranishëm në Glogjan ishte edhe kryeministri Ramush Haradinaj, i cili tha se hero i Kosovës, Agim Selmanaj, i rritur

në frymën e atdhedashurisë, u ngrre në ushtar shembullor derisa ra për t'u përjetësuar në themelet e lirisë së kësaj toke. "Lavdi e përjetshme Agimit dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tij!", ka thënë Haradinaj.



Veseli pritet në odën e Haradinajt në Glogjan

Pas homazhe të Varrezat e Dëshmorëve në Glogjan në nderim të dëshmorit Agim Selmanaj, kryeparlamentari Kadri Veseli është pritur në odën e kryeministrit Ramush Haradinaj. Aty ishte i pranishëm edhe kryeministri Haradinaj dhe deputeti Rasim Semanaj.

Kurti: Gratë e të rinjtë në përqindje dërrmuese janë pa një vend pune

Prishtinë, 1 maj (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka vlerësuar se krerët e institucioneve nuk janë të interesuar në zhvillim dhe punë, por në hajni. Ai ka kërkuar mbështetjen e të gjithëve për ta ndryshuar gjendjen në Kosovë. Sipas Kurtit, aktualisht në vendin tonë ka shumë të papunë e shumë punëtorë të keqpaguar e të keqtrajtuar. "Kosova ka shumë nevoja dhe defekte, prandaj ka mundësi për shumë vende pune. Më 1 maj 2019 jemi shumë të papunë e



shumë punëtorë të keqpaguar e të keqtrajtuar. Ta ndryshojmë situatën, të bëhemi të gjithë punëtorë, që punësimi e pagat e mirëqenia për të gjithë të rritet", ka thënë Kurti me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve. Ai ka thënë se sot do të kishte dashur të fliste për të drejtat dhe mirëqenien e punëtorëve, por ka pyetur se sa është e mundur kjo në kushtet kur çdo i dyti është i papunë? "Sidomos gratë e të rinjtë në përqindje dërrmuese janë pa një vend pune", ka deklaruar Kurti.

Kritikë politike

Sovrani t'i largojë nga qeverisja filistinët e narcistët

Përpara strukturave intelektuale dhe akademike, përpara familjeve të dëshmorëve të kombit, përpara Kushtetutës së shtetit etj., del si obligim i pashmangshëm moral e kombëtar që të reagohet bashkërendueshëm në variante të ndryshme demokratike kundër veprimtarive: korruptive, kriminale, anarkike, diskriminuese etj. që sot mbizotërojnë në Kosovë



Hasan MUJAJ

Në Kosovë, sidomos kohën e fundit, sa vjen e po merr shtrirje të gjerë edhe një fenomen, madje aq të gjerë, sa tanimë është bërë dukuri. Kjo dukuri është: punësimi sipas porosive të kryeministrit, të zëvendëskryeministrave, të ministrave të deputetëve, të liderëve të partive politike etj.

Në realitet ky lloj punësimi është një variant korupsioni, një veprim i diktatit autarkik ndaj të cilit me të drejtë pati shumë reagime e kritika edhe nga përfaqësuesit e huaj diplomatikë të akredituar në Kosovë. Për të qenë ironia edhe më e madhe, ky punësim, dmth. ky komprometim i institucioneve më të larta të shtetit, bëhet nga ndërhyrja e disa liderëve të partive politike dhe sendërtrohet nga ministrat, zëvendëskryeministrit etj. të partive përkatëse. Ky punësim, shpërdorimisht, u bë aksiomë në Kosovë.

Tani, që të jetë qesëndia edhe më komike, edhe më demagogjike, edhe më nepotiste, ky lloj punësimi i familjarëve të pushtetarëve bëhet pikërisht nga ata, të cilët, në paraqitjet e ndryshme publike, në fjalimet politike, në medie etj. parim pikënisjeje rreth punësimit e patën kriterin: një familje, një të punësuar! Por, ky princip mbeti vetëm teorik; nuk zgjati më shumë se fjalimi: u shkel nga vetë oratori që po i mashtronte qytetarët!

Statistikat përditë po dëshmojnë se në Kosovë, me shkallë të lartë të papunësisë, ku me mijëra familje rrojnë me ndihma sociale dhe, si rrjedhojë e kësaj gjendjeje të gjerë socioekonomike, është edhe ikja e madhe nga vendi, ka familje me nga dy, tre e katër të punësuar! Në ballë të kësaj dukurie antidemokratike e antihumane janë drejtuesit e shtetit të Kosovës, të cilët në fjalime e thonë njëri, e në praktikë tjetri. Këtë e bëjnë, përveç interesit material-familjar, edhe për favore politike, partiake, miqësore, farefisnore etj. Kështu, për arsyt e sipërthëna,

pushtetarët e lartë të Kosovës i futën në punë: djemtë, vajzat, bashkëshortet, kunatat, nipërit, mbesat, motrat, të vluarat e djemve, djemtë e vëllezërve etj. të kryeministrit, të zëvendëskryeministrave, të ministrave etj. Madje, një nga zëvendëskryeministrit, që prin në këtë veprimtari destruktive me disa familjarë të punësuar, i jep vetes të drejtë morale t'i bindë qytetarët në fjalimet publike se ai dhe partia politike që e drejton janë për zbatimin e rendit e të ligjit në vend, për të hapur vende të reja pune dhe, më në fund, grish të rinjtë me refrenin patriotik: "rrini këtu, mos e lëshoni vendin, po punojmë ta zhvillojmë Kosovën" e mashtrime të tjera të ngjashme!

Ky stil i retorikës mpleks në vete konotacione ironike: thuhet diç që kumbon mbresueshëm por, shpërpjesëtimi me të vërtetën, në gjuhën gjermane quhet "retorikë e zezë" (schwarze Rhetorik), që është rreng e manipulim i disa politikanëve të Kosovës etj. si në shembullin e sipërsjellë.

Në kritikën e ndryshme përkitazi me dukurinë e punësimeve të këtu, pushtetarët narcistë arsytohen me përgjigjen komike se të afërmit e tyre kanë kryer fakultetin e masterin. Hipokrizi e paparë! Në Kosovë ka me mijëra njerëz me fakultet të kryer e me master që përditë kërkojnë punë, por nuk pranohen sepse u mungon ndërhyrja e politikës, e cila në Kosovë është mbi konkurset e ligjet.

Kriter punësimi, përkatësia partiake

Përveç këtij varianti të punësimit shpërdorues që i takon interesit material, ekziston edhe punësimi i përfuturit politik duke pranuar në punë militantë të partive e të partizave politike për të shënuar kështu numër sa më të madh votuesish në zgjedhje për të qëndruar në pushtet. Edhe kjo dukuri po vërshon në Kosovë ku kriter punësimi është përkatësia partiake! Çështje plotësisht irelevante është kualifikimi, specializimi, përvoja, aftësia etj. Kjo veprimtari destruktive e qeveritarëve të lartë të shtetit me gërnja e mashtrime, e cila mbrohet e përforcohet nga disa këshilltarë të kabineteve të gjora të tyre, të cilët u

këndojnë panegjirikë për "sukseset e fjalimeve publike" semantikisht shterpë, tanimë po kritikohet e po apostrofohet edhe nga faktorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Kosnet me shumë të drejtë kërkoj reaguesit e ndryshme demokratike të qytetarëve ndesh qëndrimeve e vendimeve antiligjore të pushtetarëve që sa vijën e po shtohen. Prandaj, s'është habi që nuk ka investimeve të bizneseve të huaja për ta shpënë përpara zhvillimin ekonomik të vendit dhe për të hapur vende të reja pune sepse askush nuk investon aty ku paraprakisht kërkohen miliona euro korupsion siç janë kërkuar në Kosovë nga një qeveritar i lartë duke dëshmuar kështu se nuk ka siguri të ligjshmërisë; nuk ka zhvillim të arsimit cilësor sepse në ballë të tij janë vënë njerëz pa kompetencë të duhur arsimore që nuk dinë të shprehin si duhet në gjuhën standarde shqipe, andaj ç'arsim cilësor mund të pritet nga të paarsimuarit, të cilët, ç'është për keqardhje, sot e drejtojnë arsimin e shtetit madje MASHT-i prin nga punësimet politike sipas kriterit partiak;

nuk ka njohje të reja të shtetit të Kosovës sepse është ngritur çështja e lëvizjes së kufijve Kosovë-Serbi, e cila me të drejtë krijoi dilema se në ç'kufij të njihet Kosova shtet; sigurisht se nuk njihet shtet nga shtetet e tjera një vend që luan me kufijtë e vet në të cilët është shpallur shtet sovran dhe është njohur nga njëqind e pesëmbëdhjetë shtete; pra, ndërprerjes së njohjeve i kanë paraprirë vetë drejtuesit e shtetit etj.

Dhe jo vetëm kaq. Pasi nuk ka përgjegjësi ligjore për veprat kriminale si rrjedhojë e mosfunktionimit të institucioneve të drejtësisë, shpërdorimet korruptive janë shtrirë edhe në veprimtari të tjera p. sh.: në gjykata, të cilat aktakuzat e ngritura nga prokurorët për veprat penale kundër zyrtarëve të lartë të shtetit, ku nga ndërhyrja e politikës e ku nga korupsioni, i fshehin dhe i mbajnë në sirtarë me vite të tëra me qëllim që të vjetrohët lënda dhe kështu t'i shpëtohet dënimit.

Këshilli Prokurorial, ditë më parë, nuk lejoi praninë e ambasadorit britanik për të ndjekur korrektësinë e zbatueshmërisë së kriterëve të zgjedhjes së kryeprokurorit special me gjithë marrëveshjen pararendëse që e kishin. Përse? Për arsye se politika e kishte paraparë se cili do të jetë ai. Pra, ai që do t'i përfillë qëndrimet e politikës!

Korupsioni më i fortë se ligji!

Në fushën e shëndetësisë ka disa vjet që është bërë publike dhe

është dëshmuar me fakte afera e madhe korruptive e stentave nga e cila ndiqen shumë mjekë që shkelën betimin e Hipokratit dhe etikën mjekësore duke e vënë në rrezik jetën e njerëzve që kërkuar ndihmën e mjekut. Ka shumë kohë që drejtësia nuk merret me këtë krim, i cili mbrohet nga korupsioni që në Kosovë është më i fortë se ligji.

Kriminaliteti është shtrirë edhe në fushën e rendit e të sigurisë, aty nga duhet të burojë gatishmëria për të ndjekur e për të zbuluar krimin; në polici lejohet të punojnë zyrtarë policorë që ndiqen për veprat penale, të pamoralshëm dhe me aktakuza për vepra të dhunshme. Sa ka vërtetësi në përmbajtjen e shprehjes metaforike: "Do të ndërtojmë ura edhe aty ku nuk ka lumë", po aq janë reale edhe premtimet e disa liderëve mashtrues që i bëjnë në fjalime të ndryshme publike.

Po të mbahet parasysh përmbajtja e citatit të shkrimtarit e oratorit elitar W. v. Gëtes: "Nacionalisti më i mirë është ai që i dallon të metat e popullit të vet", e cila (përmbajtje) është me vlerë të përherëshme, atëherë përpara strukturave intelektuale e akademike, përpara familjeve të dëshmorëve të kombit, përpara ndërtimit të demokracisë së mirëfilltë dhe të Kushtetutës së shtetit etj., del si obligim i pashmangshëm moral e kombëtar që të reagohet bashkërendueshëm në variante të ndryshme demokratike kundër veprimtarive: korruptive, kriminale, anarkike, diskriminuese etj. që sot mbizotërojnë në Kosovë. Duke iu referuar citatit të Gëtes, cilat janë të metat e popullit tonë, parë nga rrethanat e sipërthëna? Ato janë: pasiviteti, heshtja e pajtueshmëria me tatëpjetën politike, ekonomike, arsimore, shëndetësore, korruptive, kriminale etj., të cilat sa vijën e po thellohen duke e rrezikuar kështu edhe sovranitetin e shtetit. Populli ynë hëpërhë del të jetë vrojtues indiferent i deformimeve të këtu. Ai, i manipuluar nga propaganda e interesit politik dhe e pretendimeve për pushtet të filistinëve karrieristë, nuk kundërshton politikën retrograde e stagnuese që drejtohet e zhvillohet nga: narcistët e kuku-vriqët, nga eristikët e poltronët, nga rabulistët e kusarët etj.

Gëte me të drejtë vuri re se shërbim të popullit për t'i mënjauar gabimet, dështimet e të metat e tij. Në kontekstin e trajtimit tonë vlen të mbahet parasysh edhe thënia e politikanit të formatit më të lartë të demokracisë e të politikës botërore - Xhon Kenedi: "Liria pa drituri është gjithmonë në rrezik!" Pragmasemantika e citatit në vështrim, shumë kontemplativ e persuasiv, është tejet e qën-

drueshme në ecurinë e politikës intrinstike dhe, si rrjedhojë e kësaj, edhe e politikës ekstrinstike në Kosovë. Sepse, qeveritarëve të lartë të Kosovës u mungojnë dituria e korrektësia e drejtimit të shtetit, e qeverisjes dhe e përfaqësimit të shtetit në relacionet ndërkombëtare. Beogradi zyrtar përfitoi nga ky diletantizëm politik i pushtetarëve të Kosovës të cilët, në fillim, gabuan rëndë që pranuan hyrjen në të ashtuquajturin dialog "teknik", por që ishte e doli dialog politik, me shtetin që nuk e njeh Kosovën shtet të pavarur. Andaj, politika e Beogradit thoshte se po "bisedon shteti me provincën e vet!" Ky qe gabim i madh i udhëheqësve të lartë të Kosovës ngase vetë e degraduan shtetin. Në dialog me Beogradin Kosova u vu në pozicion inferioriteti nga deficieti i kognicionit politik të drejtuesve të shtetit. Ndonëse me vonesë, por duhet të korrigjohet ky gabim dhe të kërkohej që dialogu të zhvillohet midis dy shteteve: Kosovë-Serbi dhe jo shtet-provincë. Kjo sa i takon politikës së jashtme.

Mirëpo, në Kosovë ka edhe probleme të tjera të politikës së brendshme, të cilat nuk mund të zgjidhen nga ata që i krijuan për favore oligarkësh për t'i përforcuar pozicionet politike duke krijuar kështu situata të ndera stagnuese në fushat më të rëndësishme të veprimtarisë nga mosfunktionimi i ligjshmërisë.

Për tejkalimin e kësaj gjendjeje, imponohet ndryshimi, të cilin mund ta bëjë vetëm sovranin që është populli. Për këtë arsye është e domosdoshme që nga qarqet akademike, intelektuale, nga mediet etj. të zhvillohet veprimtari e thukët në terren me të gjitha shtresat e qytetarëve me anë të së cilës (veprimtari) do të pasqyroheshin me fakte gabimet, dështimet, keqpërdorimet, aferat korruptive dhe pasuritë enorme të paligjshme të qeveritarëve të lartë të shtetit, sidomos të dhjetë viteve të fundit, të cilat janë bërë tema delikate trajtimi kritik edhe në nivelin ndërkombëtar si p. sh. pensionet e veteranëve mashtrues e falsifikues që u miratuan nga Komisioni qeveritar, nga eprorë ushtarakë etj.

Mashtruesit e shtetit mbrohen nga qeveritarët e lartë!

Ky status (i veteranit) u ble nga dy mijë e tre mijë euro me anë të nënshkrimeve fals të ushtarakëve, të ministrave etj. dhe tani veteranët mashtrues që i kushtojnë shtetit me miliona euro në vit, mbrohen nga qeveritarët e lartë sepse janë pjesëmarrës në mashtrim të shtetit dhe për këtë janë paguar mirë! Pra, Qeveria qendrore i

mbështet veprat penale! Skandal i paprecedent!

Për këtë skandal të drejtësisë, që tumiret nga qeveritarët, ditë më parë, pati kritika të themelta edhe nga ambasadori i Zvicrës në Prishtinë, të cilat (kritika) u përsëritën edhe nga diplomatë të tjerë, por, diplomati i shtetit mik, për kritikën e bëra, u kërcënua me dëbim nga vendi nga një ministër! Kjo do të thotë se ministri nuk do ligjshmëri, por anarki dhe kështu e mbron korrupsionin! Me të gjitha këto veprimtari kriminale duhet të njoftohen qytetarët dhe të veprohet që, në forma të ndryshme e të organizuara mirë, të ngrihet kultura politike, demokratike, qytetare, kushtetuese etj. e sovraniteti që në zgjedhjet e ardhme të mos votohen më:

ata, të cilët ose ato, të cilat i kërcënojnë edhe diplomatët e shteteve mike me largim nga vendi vetëm se e thonë të vërtetën rreth aferave të mëdha korruptive siç është rasti i veteranëve manipulues në të cilin morën pjesë edhe qeveritarë të lartë të shtetit, deputetë e ndërmjetës të tjerë; ata, të cilët, posa erdhën në qeverisje, ia shtuan pagat vetes 100 %;

ata, të cilët paradite detyrohen të shkojnë në gjykata si të akuzuar për vepra penale, kurse pasdite shkojnë në kabinetet qeveritare dhe dalin në terren për t'iu folur qytetarëve për zbatimin e ligjshmërisë dhe për zhvillimin e shtetit;

ata, të cilët ose ato, të cilat e shiten votën për t'i bërë numrat e votimit të Qeverisë në Parlament dhe që asnjëherë nuk diskutojnë për t'i parashtruar problemet e jetës së qytetarëve që i përfaqësojnë në Kuvend, d. m. th. janë plotësisht indiferentë ndaj çështjeve relevante sociale, nacionale, shtetërore, ndërkombëtare etj.; ata, të cilët ose ato, të cilat, edhe po të duan, nuk dinë të diskutojnë sepse u mungon kultura (kupto njohuritë) elementare nga retorika dhe gjuha standarde shqipe, d. m. th. nuk janë kultivues të vlerave kombëtare nga të cilat, kryesorja është gjuha standarde etj. M. F. Kuqiliani, edukatori dhe oratori virtuoz, për fjalimin publik, shkroi: "Fjalimi bazohet në ligjet e gjuhës." Më se e vërtetë.

Se gjuha standarde e një kombi, në përdorimin zyrtar, duhet të mbrohet me ligj siç veprohet në disa shtete, dëshmohet edhe nga mendimi i filozofit të shquar gjerman J. Habermas: "Gjuha nuk është pronë private." Ajo është vlera më e lartë kombëtare. Vetëm kështu, pra duke mos i votuar më ata, të cilët dhe ato, të cilat i hyjnë në lëndat larot e hipokritët që, për favorin e tyre materiale e politike, e shpuren shtetin në humnerë, porse duke i votuar ata që nuk kanë akuza për veprat penale dhe që kanë zotësi për t'i përfaqësuar e arsyetuar kërkesat e drejta të qytetarëve, mund të shënohet ndryshimi: ligji mbi të gjitha e për të gjithë dhe zhvillimi i ekonomisë së shtetit.

Për 1 maj punëtorët kërkuar të drejtat e tyre

Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve në Kosovë u shënuar me protestë të organizuar nga sindikatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Avni Ajdini, theks të veçantë në këtë protestë i ka dhënë nevojës për rritje të sigurisë dhe sigurimit shëndetësor në punë. Ndërkaq përfaqësuesit e institucioneve kanë theksuar se janë të vetëdijshëm se ende kanë shumë punë që të drejtat e punëtorëve të realizohen plotësisht

EPOKA E RE | Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 MAJ- Me protestë, në kërkim të respektimit të plotë të të drejtave të punëtorëve, është shënuar Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve në Kosovë. Sindikata të ndryshme, nën organizimin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), kanë marshuar të mërkurën nëpër sheshet Prishtinës deri para objektit të Qeverisë. Para se t'i shpaloste kërkesat e punëtorëve, duke komentuar turmën jo shumë të madhe, që ishte mbledhur për të protestuar, kryetari i BSPK-së, Avni Ajdini, ka theksuar se numri i protestuesve nuk është më i madh për shkak se një pjesë e madhe e punëtorëve punojnë edhe sot dhe nuk kanë guxuar t'i bashkohen protestës. "Te ne kemi mjaft kërkesa sociale, duke filluar nga nënshkrimi i marrëveshjes kolektive, paga minimale, duhet të nënshkruhet siguria dhe shëndeti në punë, duhet të nënshkruhet vendimi mbi skemat pensionale. Kemi një mal kërkesat për të realizuar, por ato kanë ngelur në premtime, e të cilat kërkojmë të hasin në veshin dhe personat e duhur, në mënyrë që të zbatohen praktikisht", ka thënë Ajdini.

Theks të veçantë në këtë protestë kryesindikalisti Ajdini i ka dhënë nevojës për rritje të sigurisë dhe sigurimit shëndetësor në punë. Ai ka kritikuar institucionet shtetërore për moszbatim të zotimeve për rritje të pagës minimale, e cila në Kosovë është 130 euro për personat nën 35 vjeç dhe 170 euro për personat mbi këtë moshë. Për shkak të rritjes së çmimit të shportës së qytetarit, është rritur edhe kërkesa e tyre për pagën minimale, nga 250 sa kërkohej para dy vjetësh, në 300 euro. Kryetari i Sindikatës Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës të Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka inkurajuar punëtorët protestues ta ngrehin zërin. Ai i ka bërë thirrje qeverisë që ta dëgjojë zërin e punëtorëve para se, siç tha ai, "të bëhet vonë e sheshet të mbushen plot". "Ua kujtoj institucioneve që të mos na shohin pak sot, sepse edhe në arsim filliam me pak, filliam me një protestë modeste, vazhduam me një orë grevë. Pasi ata nuk dëgjuan zërin tonë, ndodhi greva trejavëshe dhe i tërë shteti u ngre në këmbë. Nëse shteti



Haradinaj: Jemi të vetëdijshëm se ende kemi shumë punë që të drejtat e punëtorëve të realizohen plotësisht

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se qeveria është e vendosur që dialogun social ta mbajë të hapur, duke ndërmarrë njëkohësisht veprime substanciale për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të punëtorëve. Ai ka theksuar se për herë të parë është bërë nivelimi i pagave në nivel nacional për sektorin publik dhe ka nisur procedura për rritjen e pagës minimale në bashkëpunim me të gjithë aktorët socialë-ekonomikë. "Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve është rast i mirë për të reflektuar se si të vendosim një bashkërendim ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve, në partneritet me sindikatat dhe politikën, për uljen e papunësisë dhe që Kosova të ketë një treg të konsoliduar të punës. Ndonëse vendi ynë ka një rritje ekonomike prej 4.7 përqindësh me tendencë rritjeje të vazhdueshme, jemi të vetëdijshëm se ende kemi shumë punë që të drejtat e punëtorëve të realizohen plotësisht, duke zbatuar Ligjin e Punës dhe garantim të sigurisë në punë", ka thënë Haradinaj.

nuk i shikon kërkesat tona, atëherë unë jam i sigurt se ky shesh do të mbushet plot, e atëherë do të jetë edhe vonë që të merret me kërkesat tona. Prandaj i them qeverisë, merru me zërin e punëtorëve sepse nesër mund të bëhet vonë", ka thënë Jasharaj. Ndërsa nënkryetari i Sindikatës së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Nexhat Llumnica, fillimisht komentoi gjendjen e rëndë të punëtorëve në sektorin privat, duke thënë se punëtorët po vdesin çdo ditë duke mos guxuar ta ngrehin zërin për padrejtësitë që u bëhen. "Çdo ditë punëtorët lëndohen, madje edhe vdesin në vendin e punës. Nuk po flasim për kontratat e tyre të punës, sepse ato nuk ekzistojnë, sido-

mos në sektorin privat. Të gjithë e dimë se jemi të pakënaqur me

pagën minimale në sektorin privat. Jam i bindur që ata nuk guxojnë as t'i shprehin pakënaqësitë, sepse ky shtet është kapur nga politika dhe partitë politike", ka thënë Llumnica.

Në fund të protestës, në një aksion simbolik pjesëmarrësit kanë lënë disa certifikata të improvizuara "për mosrespektim të të drejtave të punëtorëve" për kryeministrin Ramush Haradinaj, ministrin e Punës, Skender Reçica dhe zyrtarë të tjerë, funksioni i të cilëve lidhet me të drejtat të punëtorëve.

Lidhur me shkeljet e të drejtave të punëtorëve, në një tryezë diskutimi mbajtur të martën, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar raportin "Të drejtat në letër". Konkurse të manipuluar, procedura gjyqësore të papërfunduara që lidhen me punën, punë 24-orëshe pa ndërprerë, mospagesë të kontributeve pensionale nga punëdhënësi, mospagesë të pagave deri në 8 muaj, privim nga pushimi vjetor dhe ai mjekësor, mospagesë për punën jashtë orarit të rregullt etj., janë disa prej shumë padrejtësive dhe shkeljeve me të cilat përballen punëtorët në Kosovë.

Ndërkaq Partia Socialdemokrate (PSD) ka thënë se 1 Maji, Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve, e gjen Kosovën me shkallën më të ulët të punësimit në Evropë, ndërsa punëtorët në ambiente pune ku dominon logjika shfrytëzuese e mënyra shtypëse. PSD-ja ka vlerësuar se mungesa e sigurisë dhe e shëndetit në vendin e punës mbetet një prej problemeve kryesore që manifestohet me numrin e madh të vdekjeve në ambientin e punës si dhe me aksidente të rënda për shëndetin e njeriut.

Reçica: Punëtorët tanë meritojnë kushte dinjitoze pune

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se punëtorët tanë meritojnë kushte dinjitoze pune, respektim të të drejtave të tyre, siguri dhe shëndet në vendin e punës. "Jo vetëm sot, në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, por çdo ditë pa reshtur ne duhet të angazhohemi për të drejtat e tyre. Me qëllim të avancimit të të drejtave të punëtorëve, ne në MPMS vitin e kaluar i kemi hyrë reformës së thellë të marrëdhënies së punës, që punëtori ynë të gëzojë të drejta të avancuara dhe ato të drejta të respektohen plotësisht. Nuk do të ndalemi së angazhuari për përmirësimin e obligimeve tona ligjore dhe morale ndaj punëtorëve tanë", ka thënë ministri Reçica.



Kryetari Ismajli dhe komandanti i ri i policisë në Shtime zotohen për bashkëpunim

SHTIME, 1 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka pritur në takim komandantin e ri të policisë në këtë komunë, toger Fatmir Limani, i cili ishte i shoqëruar nga rreshteri Nexhmedin Ahmeti. Me këtë rast, kryetari Ismajli e ka uruar toger Limanin për detyrën e re. Ismajli ka thënë se nuk do të mungojë gatish-

mëria e ndërsjellë e bashkëpunimit të mirë të deritashëm, e cila do të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim të përforsimit të sigurisë si interes parësor i të gjithë qytetarëve.

Ndërkaq komandanti i policisë, Fatmir Limani, ka theksuar se do të angazhohet maksimalisht për ruajtjen e

rendit dhe sigurisë së përgjithshme të qytetarëve të Komunës së Shtimes, duke bërë me dije se bashkëpunimi me këtë komunë do të jetë i vazhdueshëm në funksion të zbatimit të ligjit. Paraprakisht në këtë detyrë ka shërbyer kapitene Feime Bajrami, e cila ditë më parë është emëruar komandante e policisë në Drenas.

Fillon vendosja e kamerave të sigurisë në Podujevë

Podujevë, 1 maj (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) i Komunës së Podujevës është informuar për gjendjen e sigurisë në këtë komunë, sigurinë në shkolla dhe dinamikën e realizimit të projektit për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytet.

Në mbledhjen e këtij këshilli, e cila është kryesuar nga nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, është shqyrtuar edhe raporti i Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe FSK-së për gjendjen e sigurisë në këtë komunë.

Komandanti i stacionit policor në Podujevë, kapiten Bekim Zogiani, ka thënë se gjendja e sigurisë në komunë është e qetë. Ai

ka theksuar se policia është fokusuar në shtimin e aktiviteteve për parandalimin e aksidenteve dhe krijimin e sigurisë në komunikacion. Gjendjen e sigurisë në Komunën e Podujevës e kanë vlerësuar të qetë edhe përfaqësuesit e KFOR-it dhe FSK-së.

Ndërsa në lidhje me projektin e vendosjes së kamerave të sigurisë që është duke u realizuar në bashkëpunim edhe me stacionin policor të Kosovës, drejtori i Drejtorisë së Administratës, Gëzim Namani, ka bërë me dije se tashmë kanë përfunduar të gjitha procedurat e tenderimit dhe operatori i përzgjedhur ka filluar vendosjen e kamerave të sigurisë në qytet.



Sot do të mbahet stërvitja shkollë për mbrojtjen nga tërmetet në Mitrovicë



Mitrovicë, 1 maj (ER) - Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Mitrovicës, Nehat Bahtiri, është takuar me përfaqësuesit e shkollave fillore dhe të mesme të kësaj komune, ku të pranishëm ishin Gani Rama, drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë të Mjekësisë "Dr. Xheladin Deda", Hamit Beqiri, drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Teknike "Arkitekt Sinani" dhe Rasim Ujkani, drejtor i Shkollës Fillore "Harun Beka", me të cilët është diskutuar lidhur me trajnimin simulativ për vetëdijesimin dhe mbrojtjen e nxënësve nga tërmetet.

Qëllimi i këtij trajnimi do të jetë sensibilizimi, njohja dhe përgatitja e nxënësve se si duhet të

sillen dhe të mbrohen nga të gjitha rreziqet e mundshme, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri. Ky trajnim simulativ do të mbahet sot (e enjte), duke filluar nga ora 10:00 deri në orën 14:00 në hapësirën e Shkollës së Mesme të Lartë të Mjekësisë "Xheladin Deda".

Pjesëmarrëse në këtë trajnim do të jenë 21 shkolla nga kjo komunë me 450 nxënës, të përzgjedhur nga vetë drejtorët e këtyre shkollave. Gjatë këtij takimi të gjithë përfaqësuesit e shkollave kanë thënë se do të angazhohen me përkushtim të madh, në mënyrë që mbarëvajtja e këtij trajnimi të jetë në nivel sa më të mirë për shkak se është në interes për të gjithë nxënësit.

160 aktakuza për një muaj nga Prokuroria Themelore në Ferizaj

FERIZAJ, 1 MAJ (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë muajit prill 2019 ka ngritur gjithsej 160 aktakuza ndaj 181 personave për raste të

ndryshme penale. Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur shtatëmbëdhjetë (17) aktakuza ndaj njëzetë e tetë (28) personave,

kurse Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie gjatë muajit prill ka ngritur 143 aktakuza ndaj 153 personave. Prokuroria Themelore në

Ferizaj mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.



Filozofia dhe etika politike e Ukshin Hotit (3)



Prof. ass. dr. Sabri
KIÇMARI

5. Kosova dhe Evropa

Ukshin Hoti është i pari studiues në ambientin tonë shoqëror që e ka përdorur nocionin "evropeizmi i Kosovës" në vitin 1980 në revistën "Përparimi". Pra, shumë më herët sesa të fillonte demokracia në Kosovë ai do të deklarohet një evropian i bindur. Ai e koncepton Evropën e Bashkuar jo si rivendosje "të universalizmit kishtar të mesjetës", por "universalizim të drejtave të njeriut dhe të qytetarit si dhe të parimeve demokratike në Evropë" (Hoti 1995: 85). Pra Evropa e bashkuar do të jetë një Evropë e re, "e bashkuar mbi baza të dialogjikës", me intencë të qartë të ruajtjes së identitetit kombëtar. Përkundër një klime të përgjithshme mosbesimi, Hoti do të fton për kujdes ndaj Evropës, duke shkruar: "Evropa e tij (e popullit) nuk është ajo e lugetërve të kohëve të shkuara, por është Evropë e gjeneratave të ardhshme që do të dinë t'i lidhin fjetet e holla, të padukshme, të krenarisë kombëtare, të bujarisë dhe të fisnikërisë me rrezet e holla të universit, të kohës dhe të perspektivës" (Hoti 1997: 18). Ai ishte i bindur se Evropa e ka tejkaluar kriterin religjioz në përcaktimin e statusit të popujve dhe shpresonte se nëse BE dëshiron të jetë model i barazisë së popujve, "shqiptarët po ashtu kanë shanse reale të jenë të përkrahur në kërkesat e tyre legjitime". Vetëm pak kohë më vonë, ky konstatim i Ukshin Hotit do të vërtetohet katërpërisht: Evropa Perëndimore dhe SHBA do të ndërmerrin një fushatë ajrore 78-ditëshe në mbrojtje të popullit të Kosovës nga dhuna e policisë dhe ushtrisë serbe (Weller 2009: 261). Dhe më pas, shumica absolute e vendeve perëndimore do ta njihnin Republikën e Kosovës, pas shpalljes së saj në vitin 2008, para se këtë gjë ta bënin disa nga vendet e Lindjes. Shembulli i Gjermanisë Ukshin Hotit do t'i shërbente për analiza të strukturës së ardhshme të Evropës. Ai e ka studiuar me kujdes diplomacinë gjermane përgjatë procesit të bashkimit të Gjermanisë. Plani 10 pikësh i kancelarit gjerman Helmut Kohl e parashihte bashkimin e Gjermanisë si pjesë të Bashkimit Evropian, madje duke u hapur perspektivë edhe vendeve tjera të Evropës së Lindjes për bashkim në BE (Kohl 1989). Dhe, edhe idenë e tij të bashkimit të shqiptarëve, Ukshin Hoti e strukturon në akord me këtë logjikë veprimi diplomatik. Gjermanët luftonin për bashkimin e Evropës me qël-

lim të bashkimit të Gjermanisë. Ata "duke e identifikuar ndarjen e Gjermanisë me ndarjen e Evropës, rrugëdaljen e kërkonin në theksimin e një identiteti pan-evropian" (Hoti 1995: 78). Hoti i konsideron civilizimin dhe identitetin evropian si unitet i të shumtave. Në fakt debati në lidhje me civilizimin dhe identitetin evropian po vazhdon edhe sot. Civilizimi origjinal i bazuar mbi një kulturë hebreito-kristiano-greko-latine, të karakterizuar nga humanizmi, racionalizmi, laicismi dhe demokracia, është duke u luftuar ashpër nga iliberalizmi, urrejtja ndaj të huajve dhe radikalizmi i djathtë (Zakaria 1997). Megjithë këtë luftë të ashpër politike, humanizmi dhe iluminizmi evropian pritet të ngadhënjëj përballë projektit liberal. Raporti i shqiptarëve me religjionin dhe paragjykimet perëndimore rreth tyre zënë një vend të rëndësishëm në përsiatjet teorike të Hotit. Serbia ua ka mveshur shqiptarëve fundamentalizmin islam si një hipotekë. Natyrisht që një hipotekë e tillë është e padrejtë. Në kohën e socializmit në Shqipëri u mundua që hipoteka e tillë të shmangej përmes ateizmit. Hoti mendon se këtë hipotekë nuk mund ta heqim vetëm duke e theksuar areligjiozitetin e njohur shqiptar, pasi që religjioni konsiderohet si arritje e qytetërimit, por "duke u mbështetur në traditën e rrallë të tolerancës fetare ndër shqiptarë" (Hoti 1995: 84). Mund të konstatojmë madje, se raportet ndërreligjioze ndër shqiptarët janë përtej tolerancës, janë një lloj vëllazërie ndërreligjioze e llojit të rrallë.

6. Kombi, shteti dhe klasa

Raportet në mes të shtetit dhe kombit nuk duhet parë me llupë dihomike. Ukshin Hoti kritikon trendet për t'u kujdesur që të tejthekohet realizimi i interesave të shtetit përballë atyre të kombit. Vënia në raport dihomik të interesave të shtetit dhe atyre të kombit ishte veti e teorive që buronin nga vendet e real-socializmit. Kjo ndikohej jo vetëm nga përbërja multinacionale e shtetit jugosllav dhe atij sovjetik, "por edhe nga orientimi ideologjik, sipas të cilit shteti ishte në funksion të klasës e jo të kombit" (Hoti 1995: 19). Në fakt, filozofi gjerman Immanuel Kant duke shpjeguar nocionin komb pati marrë parasysh dy tipare kryesore - bashkësinë qytetare të njerëzve dhe prejardhjen e tyre (Kant 1956: 658). Edhe sipas sociologut Max Weber "Ideja e kombit përfshin bashkësinë me prejardhje dhe ngjashmëri qenësore të përbashkët" (Weber 1980: 528). Weber nuk i sheh në raport dihomik mes vete shtetin dhe kombin. John Stuart Mill, një nga përfaqësuesit më eminent të liberalizmit, si askush tjetër i kushton rëndësi ndjenjave të ndërsjella në

mes njerëzve si elementë konstituues të kombit: "Një ndjenjë e tillë e bashkimit kombëtar me njëri-tjetrin mund të rrjedhë nga arsye të ndryshme. Mund të rrjedhë nga raca dhe prejardhja e njëjtë; përbashkësia e gjuhës dhe religjionit e nxisin këtë në mënyrë vendimtare. Edhe kufijtë gjeografikë paraqesin një arsye për paraqitjen e ndjenjës kombëtare. Por, në këtë kuptim, më së shumti ndikon një e kaluar e përbashkët politike: ekzistenca e një historie kombëtare dhe përbashkësia e kujtimeve që rrjedhin nga ajo, ndjenjat kolektive të krenarisë dhe të marres, të gëzimit dhe të vuajtjes, të cilat lidhen me ngjarjet e të kaluarës" (Mill 1971: 2419).

Ukshin Hoti e preferon njëjtësimin e interesave të shtetit me ato të kombit. Edhe ai konstaton se "kombin e përbën pozita e tij gjeografike, pasuritë natyrore, kapacitetet industriale, teknologjia, morali dhe elemente tjera të ngjashme. Në të vërtetë, kombin e përbëjnë të gjithë elementët që e përbëjnë shtetin" (Hoti 1995: 22). Dhe, Ukshin Hoti nuk ka asnjë hezitim në përsiatjet e tij teorike, për të vënë interesin e kombit para atij të klasës: "Shteti i identifikuar me kombin, shteti-komb, sipas teorikëve të botës perëndimore, ndodhet në funksion të interesave kombëtare, në funksion të kombit dhe jo të klasës" (Hoti 1995: 25).

Ukshin Hoti polemizon edhe me ndonjë tezë frojdiste rreth reaksioneve instinktive të individit. Pyetja polemike e Ukshin Hotit në këtë rast është: "Si shpjegohet gatishmëria e njerëzve-individë që ta flijojnë jetën e tyre për një ideal ose për atdhe?" Po e kontekstualizojmë pyetjen e Ukshin Hotit: Si shpjegohet përgjigja lapidare e Fehmi Lladrovci në pyetjen e gazetarit, nëse do të ishte në gjendje të vdiste për Kosovën?

"Gjithqysh. Me dëshirën më të madhe. Më e shtrenjtë është liria se jeta... Ai do të ishte fati im më i madh..."


Në rrafshin teorik këtë gatishmëri për vetëmohim patriotik e shpjegojnë dy filozofë bashkëkohorë: Charles Taylor dhe Alasdair MacIntyre. Taylor profetizon rolin e patriotizmit edhe për të ardhmen si një "kështjellë të fortë të lirisë... pa mundur të zëvendësohet me diçka tjetër" (Taylor 1995: 122). Sipas MacIntyre, patrioti i përkushtohet "veçse një mënyrë të caktuar të lidhjes së një të kaluarë, e cila e ka veshur atë me një identitet të dallueshëm moral dhe politik, me një të ardhme për këtë projekt që është kombi i tij dhe që ai ka përgjegjësinë për ta sjellë në jetë" (MacIntyre 1995: 92).

Në kontekst të raporteve shtet-komb, Ukshin Hoti kritikon Bashkimin Sovjetik, i cili synonte të krijonte artificialisht një komb sovjetik. Ai i zhvesh tendencat asimiluese rusomëdha në BRSS përmes instrumentalizimit të gjuhës ruse si mjet politik, duke i

dhënë prioritet klasores mbi nacionalen dhe internacionales mbi nacionalen, me qëllim të asimilimit dhe realizimit të interesave rusomëdha. Synimet e tilla për formimin e kombit-shtet sovjetik e kishin vetëm një qëllim - atë të rusifikimit të nacionaliteteve të tjera sovjetike dhe asimilimin e tyre: "Ideologjia komuniste dhe teoria marksiste në këtë mënyrë ishin vënë në shërbim të aspiratave dhe interesave vitale të kombit rus" (Hoti 1995: 61). Por, siç edhe pritej, një projekt i tillë i krijimit të kombit artificial do të dështonte dhe do të thyhej si një fluskë sapuni pas rënies së sistemit njëpartiak në vitin 1991.

7. Viti 1981 si moment kyç në historinë tonë të re

Në një ligjëratë të mbajtur më 14 prill 2011 në Akademinë Diplomatike të Vjenës, me titull "Rruga e integritetit të Republikës së Kosovës drejt BE", pata konstatuar se "gjatë Luftës së Ftohtë ka pasur tri momente, të cilat i dëshmuar opinionit publik ndërkombëtar, se raportet sociale, nacionale dhe ndërshtetërore në dhe mes shteteve të Bllokut të Lindjes, përkatësisht, shteteve socialiste, nuk ishin të drejta. Dy nga këto momente - Pranverën e Pragës të vitit 1968 dhe Lëvizjen e Solidarnoshçit të vitit 1980 - i ka identifikuar si të tilla teoria politike bashkëkohore ndërkombëtare, por jo edhe momentin e tretë - Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, me gjithë faktin se ato ishin një shenjë e parë e një lëvizjeje për liri të shumë kombeve nga ish-RSFSJ dhe ish-Bashkimi Sovjetik. Në përfundim të këtij procesi lirie u krijuan një numër i konsiderueshëm shtetesh të reja" (Kiçmari 2011). Prandaj, viti 1981 për botën shqiptare mund të konsiderohet si vit me histori, ose edhe më qartë: vit i kthesës historike. Duke e rilexuar veprën e Ukshin Hotit, arrita të konstatoj se pikëpamjet e mia përputhen plotësisht me ato të Ukshin Hotit. Ai në analizat e tij teorike e koncepton si moment kyç në historinë tonë të re vitin 1981. Ai shkruan se shqiptarët në vitin 1981 "vendosën ta merrin fatin e tyre në duart e veta, dhe të vetmuar, por të vendosur, u nisën drejt Evropës!" (Hoti 1995: 13). Në argumentimin e kërkesës për Republikën e Kosovës ai është decidiv: "Republika e Kosovës, si do që të duket, mund të konsiderohet zgjidhje e pjesshme, paliative e çështjes shqiptare. Mirëpo zgjidhjet paliative të çështjeve të mëdha mund të konsiderohen dhe janë cilësi e luftës politike dhe produkt i mençurisë së faktorit politik shqiptar në vlerësimin e tërësishëm të rrethanave, rrugës së zhvillimit të proceseve dhe synimeve përfundimtare të tyre" (Hoti 1995: 58). Pra, Ukshin Hoti e koncepton idenë e Republikës së Kosovës jo si një zgjidhje e menjëhershme dhe definitive e çësht-



jes shqiptare, pos si një fazë e ndërmjetme në afirmimin e proceseve integrative në Evropë. Prandaj, ai insiston në mënyrë kategorike në tri premisat e tij themelore: "a) për ruajtjen e integritetit territorial të Jugosllavisë; b) për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë; dhe c) për Republikën e barabartë të Kosovës në Jugosllavi" (Hoti 1995: 96).

Luftën tonë politike për Liri dhe Republikë Hoti e kupton edhe si të "motivuar nga nevojat reale të popullsisë shqiptare për zhvillim" (Hoti 1995: 58). Republika e Kosovës, sipas tij, është realizim i njërit prej interesave vitale të kombit. Si e tillë, mund të qëndrojë vetëm në funksion të bashkimit por edhe të forcimit të raporteve të reja në gjithë territorin e Ballkanit, të Mesdheut dhe të Evropës" (Hoti 1995: 58-59). Viti 1981 është vit i kthesës historike për Ukshin Hotin, "është nyja, zbërthimi i së cilës e mundëson lëvizjen e drejtë të gjërave dhe të proceseve" (Hoti 1995: 59). Përse pikërisht viti 1981? Përgjigja e tij është hegeliane: "Sepse vitet tjera nuk e ndryshuan historinë. Të gjitha vitet i ndihmuan zhvillimit të historisë. Do të thoshim se vitet tjera i ndihmuan akumulimit të proceseve, rritjes së kuantitetit, por kërcimin kualitativ, vetë shndërrimin e kuantitetit në kualitet, e bëri vetëm viti 1981" (Hoti 1995: 60). Kërkesën për Republikë Ukshin Hoti e koncepton si kërkesë për evropeizim, përkatësisht, për barazimin dhe nivelizimin e zhvillimit me shtetet e zhvilluara të Evropës. Jetësimi i Republikës së Kosovës do të stimulonte proceset integrative në Evropë të vendeve të Evropës Juglindore.

Edhe pse në demonstratat e vitit 1981 kërkesa për barazi dhe republikë ishte shprehur edhe në formë të parullës luftarake "Republikë, kushtetutë - ja me hatër, ja me luftë", pak veta e patën marrë seriozisht luftën si një mundësi reale. Por Ukshin Hoti bën një përjashtim. Ai është i vetëdijshëm sa i rëndësishëm është krijimi i ushtrisë, policisë, qeverisë etj. Luftën për Republikë ai e kupton si një luftë për ekzistencën e Kosovës, jo si konotacion gjeografik, por politik. Dhe mundësinë e luftës e parashikon në mënyrë pothuajse profetike: "Lufta nuk është perspektivë as për popullin shqiptar, por mundësitë për evitimin e saj nuk janë absolute" (Hoti 1995: 104).

(Vijon)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



Bisedë me Milan Kunderën

KULTURËS I DUHEN KUF

Bisedoi: Olga CARLISLE

Çehres së tij ia ka marrë anën muzgu i Parisit; i shihen vetëm sytë e kaltër. Flet ngadalë, me një frëngjishte të zgjedhur, me theks të fortë të sllavishtes. "Vetëm krijimtaria letrare që vë në pah një fragment të panjohur të ekzistencës njerëzore ka arsye të ekzistojë", thekson ai në një intervistë të gjatë pasuese me pyetje dhe përgjigje. "Të jesh shkrimtar nuk do të thotë vetëm të predikosh të vërtetën, por do të thotë të zbulosh një të vërtetë".

Në vitet 1980, Milan Kundera, 56 vjeç, ka bërë vendlindjen e tij, Çekoslovakinë, çfarë Gabriel Garcia Marquez bëri për Amerikën Latine në vitet 1960 dhe Aleksandr Solzhenitsyn për Rusinë në vitet 1970. Ai ia ka kujtuar Evropën Lindore lexuesit perëndimor dhe këtë e ka bërë me thellësinë e të vërtetave që janë universale për nga thirrja e tyre. Thirrja e tij për të vërtetën dhe për lirinë e brendshme pa të cilën nuk mund të njihet e vërteta, gjakimi i tij se vetëm duke kërkuar të vërtetën në përgatitimi të mësohemi me vdekjen - këto janë temat që i kanë dhënë atij mirënjohje kritike, përfshirë Çmimin e Jerusalemit për Letërsi dhe Shoqëri të Njeriut në Shoqëri që i është ndarë para dy javësh. Vepra më e re e Kunderës, "Libri i të qeshurës dhe harresës" (1980) dhe ajo e vitit të kaluar "Lehtësia e padurueshme e qenies", merren me vdekjen e kulturës në kohën tonë. E shprehur troç nëpërmjet ndjenjës së kërcënimit është rreziku i luftës bërthamore. Kundera merret me këtë rrezik në mënyrë alegorike, me ndjenjën e pashtypur të groteskut.

Si bashkatdhetari i tij, Milosh Forman, regjisori i çmimit kryesor të Akademisë Amerikane të Filmit, i cili i ishte përshtatur ekzilit dhe ia ka dalë të lulëzojë në Perëndim, edhe Kundera, i cili jeton në Francë prej vitit 1972, ka qenë shumë i frytshëm sa për ta mohuar pretendimin e shumëpërfolur se shkrimtarët që largohen nga vendlindja humbin frymëzimin. Vepër pas vepre, lexuesi ndjen pasion, lojën e madhe dhe frymën e erotizmit. Kundera ia ka dalë ta kthejë Çekoslovakinë e rinisë së tij në një tokë erotike, mitike dhe të gjallë.

Natyrë e arritjes së tij mund të shpjegojë pjesërisht pse Kundera e mbron fort privatësinë e tij. Asnjë krijues mitesh a mistifikues nuk dëshiron të shpalojë. Në një intervistë

dhënë së fundmi, novelisti Philip Roth citonte Kunderën t'i ketë thënë: "Kur isha çunak me shortse të shkurta, ëndërroja një kremë mrekullibërëse që do të më bënte të padukshëm. Pastaj u rrita, nisa të shkruaja dhe doja të bëhesha i suksesshëm. Tani jam i suksesshëm dhe do të doja ta kisha atë kremë që do të më bënte të padukshëm".

Pritshëm, ndihej mungesa e entuziazmit në zërin e Kunderës kur e telefonova në banesën e tij në Paris nga San Francisko, për t'i kërkuar të më pranonte për një intervistë. Ndihma më erdhi prej një qoshe të papritur - kujtim i gjyshit tim, dramaturg rus Leonid Andreyev. I paralajmëruar nga miqtë se nënshtrimi sovjetik i vendit të tij ia kishte mbushur mendjen Kunderës t'i shihte me dyshim rusë - të gjithë rusët - ndieja se duhej ta tregoja prejardhjen time ruse.

Kundera ma ktheu se në rini kishte lexuar dhe admiruar krijimtarinë e gjyshit tim. Kështu, u thye akulli, dhe lamë datën e takimit për intervistën. Por në një letër që e mora pak kohë pas asaj bisede telefonike, Kundera shkruante: "Më duhet t'ju paralajmëroj se nuk jam njeri që ju shkoj për qejfi. Nuk jam i zoti kur vjen puna për të folur për veten, jetën time dhe gjendjen e shpirtit tim. Jam diskret pothuajse deri në nivel patologjik, dhe në këtë pikë nuk mund të bëj asgjë. Nëse nuk ju prish punë kështu, do të doja të flisnim për letërsinë".

Milan Kundera dhe gruaja e tij, Vera, jetojnë në rrugët e qeta anësore të Montparnasset; banesa e tyre e vogël është një banesë pullazi e rimodeluar me pamje kah pullazet e hirta parisiane. Ajo çfarë e shquan dhomën e pritjes janë pikturat moderne surrealistike në mure. Disa sosh janë të artistëve çekoslovakë, të tjerat të vetë Kunderës - koka të stërmëdha shumëgjyreshë dhe duar me gishta të gjatë, si të vetë Kunderës.

Vera Kundera është një brune e hijshme, flokëshkurtër, hollake me xhinse të kaltra. Na shërben verë dhe mjeshtërisht na qëron kivi. Derisa lëshohemi në muhabet, mahnitem me mirënjohjen e çiftit për anën festive të jetës parisiane - qejfi për të bërë pazar në Bon Marchen në afërsi, frutat ekzotike në dyqanin në qoshe të lagjes, ekspozitat e shumta gjatë gjithë vitit. Por më vonë gjatë intervistës, Vera është e zënë në dhomën tjetër, duke shkruar me makinë shkrimi dhe duke iu përgjigjur thirrjeve telefonike nga vende të largëta.



Edhe Kunderën e ka rrëmbyer jeta e famshme dhe i ka rënë gruas hise që të merret me menaxhimin e kërkesave që vijnë prej televizioneve, kinemave dhe regjisorëve evropianë të filmit.

I gjatë dhe hollak, me një duks të kaltër të vjetër, Kundera lëshohet në kolltuk. Dhe ky është vendi ku ky burrë ndihet më së miri - bien dans sa peau - nëse do ta përdornim shprehjen franceze të cilën e ka shpalosur gjerë e gjatë në "Lehtësia e padurueshme e qenies". E inkurajuar prej pyetjeve të tij, i tregoj pak për fëmijërinë time si emigrante në Paris. Mahnitja ime me Pragën lidhet me ato ditë të dikurshme, kur poetja ruse emigrante, Marina Tsetayeva, na vizitonte mbrëmjeve dhe recitonte vargjet e saj, zërin e saj grykor. Një poemë që kurrë s'e harrova i ishte kushtuar njëherë prej shtatoreve mbi urën që këpuste lumin Vltava, një kalorësi që hidhte shikimin mbi Pragën: Kalorësi Pale, është gardian i lumit që spërkat, i viteve që kalojnë, teksa shikon

unaza dhe traktate, që përplasen faqeve të gurëve të argjinaturës. Janë thyer sa e sa sosh gjatë katërqind vjetëve të fundit.

Duhet të kenë qenë vitet 1936 ose 1937, por edhe atëherë Praga ishte shumë me Gjermaninë naziste dhe me Rusinë komuniste gjithashtu. Përmasat e tradhtive që do të vinin dhe premtimet e shkelura as mund të merreshin me mend.

Kundera ishte pjesë e Pranverës së Pragës së vitit 1968, premtimit të socializmit me fytyrë njeriu që ishte shtypur brutalisht nga tanket sovjetike. Botimi në Pragë i veprës së tij të parë, "Shakaja", ishte një prej ngjarjeve të mëdha që do të konsideroheshin të huaja për sistemin.

Shkruar me kujdes dhe kompozuar shtjellueshëm, "Shakaja" ishte padi ndaj absurditetit gri të jetës nën komunizëm, por edhe e jetës kudo kur tradhtia dhe hakmarrja lejohen të të gërryejnë shpirtin. Dorëshkrimi kishte mbërritur deri në shtëpinë

botuese të Parisit, "Editions Gallimard" dhe shumë shpejt do ta rrokte edhe vëmendjen ndërkombëtare. Pas pushtimit sovjetik të Çekoslovakisë, Kundera humbi pozitën e tij si profesor në Institutin për Studime të Avancuara Kinematografike në Pragë dhe veprat e tij u ndaluan. Pak nga pak, jeta po bëhej e padurueshme për të dhe nuk i kishte mbetur tjetër derë, pos të largohet nga vendlindja.

Veprat që do të binin pastaj në duar të lexuesve perëndimorë në vitet pasuese do të shpinin në një udhëtim intelektual dhe emocional. "Jeta është diku tjetër", botuar më 1974 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ishte një eksplorim me humor të zi të pasojave të fundit të revolucionit dhe zellit poetik. "Dashuria qesharake" (1974) dhe "Valsi i lamtumirës" (1976) i thurnin lavde dashurisë erotike dhe përzierin hilaritetin me pasionin. Në "Valsi i lamtumirës" ka një moment që të shtangë. Kur njëri prej karaktereve të tij, Jakobi, ndan

IJTË E HAPUR



jët. Ka një mijë vjet qysh se Çekosllovakia është pjesë e Perëndimit. Sot është pjesë e perandorisë së lindjes. Më i parrënjë do të ndihesha në Pragë sesa në Paris.

Olga Carlisle: Por ju ende shkruani në çekisht?

Milan Kundera: Esetë i shkruaj në frëngjisht, por novelat në çekisht, sepse përvojat e mia të jetës dhe imagjinata ime jetojnë në Bohemi, në Pragë.

Olga Carlisle: Ishte Milosh Forman, ai i cili para jush e bëri Çekosllovakinë të njohur për një publik më të gjerë në Perëndim, nëpërmjet filmave si "The Fireman's Ball".

Milan Kundera: Në të vërtetë, ai është inkarnim i asaj çfarë unë e quaj fryma e Pragës - ai dhe regjisorët e tjerë çekë, Ivan Passer dhe Jan Nemeč. Kur Miloshi vjen në Paris, të gjithë tronditen dhe verbohën. Si ka mundësi që një regjisor të jetë indiferent ndaj snobizmit? Në Paris, edhe një shitëse njomake në Galeries Lafayette nuk di si të sillt natyrshëm. Thjeshtësia e Formanit duket si provokim.

Olga Carlisle: Si do ta përshkruanit "frymën e Pragës"?

Milan Kundera: "Kështjella" e Kafkës dhe "Ushtari i mirë Schweik" i Jaroslav Hasekut janë të mbushura me atë frymë. Ndjenjë e jashtëzakonshme e reales. Pikëpamja e njeriut të rëndomtë. Ta shohësh historinë nga poshtë. Thjeshtësi provokuese. Gjeni absurdi. Humor plot me pesimizëm të pafund.

Olga Carlisle: Ta zëmë, një çek kërkon vizë emigrimi. Zyrtari e pyet: "Ku dëshironi të shkoni?" "Nuk ka rëndësi", ia kthen burri. I ofrohet një glob. "Ju lutem, zgjidhni".

Milan Kundera: Burri i botës e shikon globin, e sjell ngadalë dhe e pyet: "A nuk keni edhe një tjetër glob?"

Olga Carlisle: Përveç rrënjëve tua në Pragë, cilat kanë qenë pasionet e tjera letrare që ju kanë formësuar?

Milan Kundera: Së pari, novelistët francezë, Rabelais dhe Diderot. Për mua, themeluesi i vërtetë, mbreti i letërsisë franceze, është Rabelais. Dhe "Zhak fatalisti" i Diderotit ngërthenin frymën e Rabelais në shekullin e tetëmbëdhjetë. Mos u ngatërrohi nga fakti se Diderot ishte filozof. Kjo novelë nuk mund të tkurret në diskurs filozofik. Është dramë ironie. Novela më e lirë e shkruar ndonjëherë. Liri e kthyer në novelë. Kam bërë së fundi një përshtatje të saj për teatër. U vu

në skenë prej Susan Sontag në Cambridge Massachusetts, si "Zhaku dhe i zoti i tij".

Olga Carlisle: Rrënjët tua të tjera?

Milan Kundera: Novela e Evropës Qendrore e shekullit tonë. Kafka, Robert Musil, Herman Broch, Witold Gombrowicz, këta novelistë nuk ndjekin - e bëjnë në mënyrë madhështore - atë që Andre Malraux i quante "iluzione lirike". Janë mosbesues të iluzioneve që shqetësohen për përparimin, mosbesues ndaj kështjës së shpresës. Ndaj keqardhjen e tyre të madhe për muzgun perëndimor. Nuk është punë e keqardhjes sentimentale. Është ironike. Dhe rrënjët e tjera, të tretat: poezia çeke moderne. Për mua ishte shkollë e madhe e imagjinatës.

Olga Carlisle: A ishte Jaroslav Seifert ndër poetët modernë të cilët ju kanë frymëzuar? A e meritoi ai çmimin Nobel që iu nda më 1984?

Milan Kundera: Pa dyshim se e meritoi. Është thënë se për herë të parë ishte propozuar për çmimin Nobel më 1968, por juria ishte treguar e matur; drante se çmimi që do t'i ndahej atij do të konsiderohej si gjest i keqardhjes për një vend të pushtuar së fundmi.

Çmimi iu nda tepër vonë. Tepër vonë për popullin çek, i cili ishte poshtëruar. Tepër vonë për poezinë çeke, epoka e madhe së cilës kishte përfunduar kaheerë. Tepër vonë për Seifertin, i cili ishte 83 vjeç. Thuhet se kur ambasadori suedez i kishte shkuar te shtrati në spital për t'i treguar për nderin, Seiferti e kishte shikuar një copë herë. Në fund i kishte thënë zemërthyesëm: "Po çfarë do të bëj tani me krejt këto para?"

Olga Carlisle: Çfarë mendoni për letërsinë ruse? A ju prekin ende, apo mos ju kanë bërë mosbesues ndaj letërsisë ruse zhvillimit politike të vitit 1968?

Milan Kundera: Më pëlqen jashtëzakonisht shumë Tolstoy. Ai është larg më modern se Dostoyevsky. Tolstoy ishte i pari, mbase, që i ra në sy roli i irracionales në sjelljen njerëzore. Roli i luajtur prej budallalëkut por, kryesisht, pa dhënë llogari për veprimet njerëzore të udhëhequra prej subkoshiençës që është edhe e pakontrolluar, edhe e pakontrollueshme.

Rilexoni paragrafët që i prijnë vdekjes së Ana Kareninës. Pse e vrau veten pa e pasur ndërmend? Si e mori vendimin? Për të kapur këto arsye, që janë

irracionale dhe të pakuptueshme, Tolstoy pasqyron rrjedhën e ndërjegjes së Anës. Ajo është në pajton: imazhet e rrugës përzihen në kokën e saj me mendime të copëtuara, jologjike. Krijuesi i parë i monologut të brendshëm nuk ishte Joyce, por Tolstoy, në këto pak faqe të "Ana Kareninës". Kjo rrallëherë pranohet. Sepse Tolstoy është përkthyer keq. Njëherë kam lexuar një përkthim francez të këtij paragrafi. U mahnita. Çfarë në tekst origjinal është jologjike dhe e copëtuar, bëhet logjike dhe racionale në përkthimin francez. Sikur të rishkruhej kapitulli i fundit i "Ulksit", monologut të gjatë të Molly Bloomit do t'i jepej karakteri logjik, me shenja pikësimi konvencionale. Andaj, përkthyesit na tradhetojnë. Nuk kanë guxim të përkthejnë të pazakonshmen në tekstet tona - të parëndomtën, origjinalen. Druajnë se kritikët do t'i akuzojnë për përkthim të keq. Për ta mbrojtur veten, i zbusin gjërat për ne. Nuk keni ide sa shumë mund dhe kohë kam humbur duke korriguar përkthimet e veprave të mia.

Olga Carlisle: Flisni me pasion për babanë tuaj në "Libri i të qeshurës dhe harresës".

Milan Kundera: Babai im ishte pianist. Kishte pasion për muzikën moderne - për Stravinskyn, Bartokun, Schoenbergun, Janacekun. Luftoi fort për ta njohur Leos Janacekun si artist. Janacek është kompozitor modern mahnitës, i pakrahasueshëm, e pamundshme ta klasifikosh. Opera e tij, "Nga shtëpia e të vdekurit" për kampet e punës së rëndë, bazuar në novelën e Dostoyevskyt, është prej veprave më të mëdha dhe më profetike të shekullit tonë, si "Procesi i Kafkës" ose "Guernika" e Picassos.

Babai im e performonte këtë muzikë të vështirë në salla koncertesh që ishin pothuajse boshe. Si djalos i vogël, urreja publikun që refuzonte të dëgjonte Stravinskyn dhe duartrokiste Tchaikovskyn ose Mozartin. Më është rikthyer pasioni për artin modern; kjo vjen për shkak të babait. Por refuzoja që ta zgjidhja profesionin e tij prej muzikanti. Më pëlqente muzika, ama jo edhe muzikantët. Më qeshej me mendimin se mund ta kaloja jetën në mesin e muzikantëve. Kur unë dhe gruaja u larguam nga Çekosllovakia, mund të merrnim një pak libra me vete. Në mesin e tyre ishte edhe "Kentauri" i John Updikes, një vepër që më kishte prekur loçkën e zemrës - një dashuri me vuajtje për babanë e mposhtur e të nëpërkëmbur.

Olga Carlisle: Në "Libri i të qeshurës dhe harresës", ju lidhni kujtimin e babait tuaj me një tregim për Taminan, që jeton në një ishull ku ka vetëm fëmijë.

Milan Kundera: Ky tregim është

një ëndërr, një imazh ëndërr që më nuk më shkoqet nga mendja. Imagjinojeni veten t'i kaloni ditët e mbetura të jetës rrethuar prej fëmijëve, pa pasur madje as edhe një rast të vetëm që të ndërroni ndonjë llaf me një të rritur. Ankh i vërtetë. Prej nga vjen imazhi? Nuk e di. Nuk më pëlqen t'i analizoj ëndrrat. Preferoj t'i kthej në tregime.

Olga Carlisle: Fëmijët zënë vend të çuditshëm në veprat tuaja. Në "Lehtësia e padurueshme e qenies", fëmijët torturojnë një sorrë, dhe Tereza papritmas i thotë Tomasit: "Të jam mirënjohës që nuk ke dashur fëmijë". Në anën tjetër, në veprat tuaja shihet një dashamirësi e treguar ndaj kafshëve. Në veprën tuaj të fundit, një derr na del një karakter i pëlqyeshëm. A nuk është paksa iç kjo pikëpamje për kafshët?

Milan Kundera: Nuk pajtohem. Kiçi është dëshirë për t'i kënaqur njerëzit me çfarëdo çmimi. Të flasësh mirë për kafshët dhe t'i shikosh me skepticizëm fëmijët nuk është se i kënaq kushedi sa njerëzit. Madje edhe mund t'i irritosh. Nuk është puna se kam diçka kundër fëmijëve. Por kiçi i fëmijërisë më acaroi. Këtu në Francë, para zgjedhjeve, të gjitha partitë politike kishin posteret gjithandej. Gjithkrah të njëjtat slogane për të ardhme më të mirë dhe gjithkrah fotografi fëmijësh që qeshen, vrapojnë dhe luajnë.

Mjerisht, e ardhmja jonë njerëzore nuk janë fëmijët, por pleqëria. Humanizmi i vërtetë i shoqërisë vihet në pah nëpërmjet sjelljes së njerëzve ndaj pleqve. Por pleqëria, e ardhmja e vetme me të cilën përballemi gjithsecili prej nesh, asnjëherë nuk do të shpalojë në posterë propagande. As nga e majta, as nga e djathta politike. E shoh se belaja ndërmjet të djathtës dhe të majtës nuk ju mahnit kushe-di sa.

Olga Carlisle: Rreziku që na kërcënon është perandoria totalitare. Khomeini, Mao, Stalini, a janë ata majtës apo djathtës?

Milan Kundera: Totalitarizmi nuk është as i majtë e as i djathtë dhe brenda perandorisë, zhduken dy drejtimet politike. Unë kurrë nuk kam qenë besimtar, por pasi pashë katolikët çekë teksa po persekutoheshin gjatë terrorit të Stalinit, u solidarizova nga thellësia e zemrës me ta. Çfarë na ndan, besimi në Zot, ishte e dorës së dytë krahasuar me atë që na bashkonte. Në Pragë ata varën socialistët dhe priftërinjtë. Kështu, lindi vëllazëria e të varurve. Kjo është arsyeja pse lufta kryeneçe ndërmjet të majtës dhe të djathtës më duket e dalë mode dhe goxha provinciale. Urrejtja përfshihet në jetën politike, megjithëse politika më mahnit si shou. Një shou tragjik, vdekjeprurës në perandorinë e lindjes; një shou shterpë në aspektin intelektual, por mahnitës në Perëndim.

Vijon

E rrallë

Shpenzoi 4 000 dollarë për muskuj të rremë në bark

Një fans i çmendur i kirurgjisë plastike ka shkuar në ekstrem. Ai ka bërë një ndërhyrje që të bëjë muskuj të rremë në bark, kjo për t'u dukur si një mashkull i palestruar. Pangpaparn Ounvilai, 24 vjeç, nga Tajlanda ka bërë një procedurë të çuditshme kozmetike që përfshin liposuction për ta hequr yndyrën nga pjesët e stomakut, që më pas zbulon linjat natyrore të barkut. Ounvilai ka pasur edhe disa operacione në të kaluarën dhe tashmë shpenzoi 4 000 dollarë për t'i rritur



muskujt e stomakut sepse stërvitja nuk mund t'i jepte atij trupin që donte.

FOTO E DITES



Kjo fotografi është shkrepur në Lemmie të Gjermanisë. /AP/

E jashtëzakonshme

Çifti gjen një thesar me monedha ari, mister pronari

Gjashtë vjet më parë, në vitin 2013, një çift gjeti një thesar pranë shtëpisë së tyre. Thesari përmbante monedha me vlerë rreth 27 000 dollarë, por vlera historike e tyre e ngriti çmimin me një total prej 10 milionë dollarësh. Çifti planifikon ta

shesë atë në "Amazon". Ata thonë se nuk do ta zbulojnë vendin ku zbuluan thesarin me frikë se njerëzit do të vinin në kërkim për më shumë. Pronari i vërtetë i thesarit "Ridge Shore" mbetet një mister edhe pas gjashtë vitesh.



BARSOLETA E DITËS



Djali:
- Babi, a është e vërtetë se në disa vende burrat nuk i njohin gratë para martesë?
Babai:
- Ajo ndodh në të gjithë planetin bir. Pasi martohesh e merr vesh se kush është gruaja.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

"THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.
Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
Regjia: Academy Award®-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Sot i gjithë fokusi juaj është i përqendruar te puna. Keni lënë pak pas dore partnerin, por do të rikuperoni në darkë.</p>	 <p>DEMI Hëna në shenjë nuk ju bën shumë miq të mirë sot. Megjithatë, do të neutralizoni gjithçka gjatë pasdites në një ambient familjar.</p>	 <p>BINJAKËT Një ditë shumë me fat sa iu përket financave. Do të merrni lajme të mira kudo ku keni pasur ide për investime ose punë të reja.</p>	 <p>GAFORRJA Do t'ju duken më të lehta problemet e ditës falë pranisë së Hënës në shenjën tuaj. Kursimet tuaja do të jenë shumë të kënaqur që i keni për sot.</p>	 <p>LUANI Megjithëse sot ndiheni në qendër të vëmendjes, mos mendoni se bota rrotullohet rreth jush.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Ditë e qetë kjo e sotmja dhe ju po ndiheni mjaft mirë me këtë qetësi. Në fund të fundit pak pushim nuk mund t'ju bëjë veçse mirë.</p>
 <p>PESHORJA Me optimizmin dhe dashurinë tuaj arrini të përçoni mjaft energji pozitive tek të tjerët. Dita sot paraqitet e këndshme.</p>	 <p>AKREPI Një ditë shumë e lodhshme si nga aktivitetet dhe nga njerëzit që ju rrethojnë. Do t'ju duhet të përballeni vetë me pjesën më të madhe të gjërave.</p>	 <p>SHIGJETARI Me tre planetë në shenjën tuaj sot, bëhuni gati që të fitoni lotarinë. Është një ditë mjaft e favorshme për çdo investim.</p>	 <p>BRICJAPI Sot jeni të pakënaqur me disa situata që sapo i keni vënë re. Do të shkoni te ankoheni tek miku juaj më i mirë.</p>	 <p>UJORI Do të preferoni vende ku lëvrohet kultura dhe arti sot. Jeni shumë të dashuruar me kulinarinë e mirë dhe do ta kënaqni shpirtin dhe stomakun.</p>	 <p>PESHQIT Një ditë shumë e bukur mbushur me ngjarje të reja. Do të keni një miks të pasionit dhe xhentilesës me partnerin.</p>

Hyland zbulon problemin me flokët



Sarah Hyland ka zbuluar se ka përdorur shtesa të flokëve për rolin e saj si Haley në Modern Family pasi u përballë me rënie të flokëve. Flokët e aktore 28-vjeçare filluan të bien si rezultat i operacioneve që kishte nevojë t'i bënte për shkak të

sëmundjes së endometriozës dhe problemit me veshkat. "Me medikamente dhe gjëra të tilla mund të bien flokët", ka pohuar Sarah për "Refinery29". "Kështu që unë vendosja shtesa flokësh për ta fshehur atë humbje", ka treguar ajo.

Lopezi për shtatzëninë e binjakëve: Isha e shokuar, por shumë e lumtur



Këngëtarja shumë e famshme, Jenifer Lopez, ka dhënë një intervistë shumë të veçantë. Ajo është "intervistuar" nga fëmijët e saj binjakë, Max dhe Emme. Të dy i bënë shumë pyetje, por më interesante ishte ajo: se si u ndje nëna e tyre kur e zbuloi se ishte shtatzënë dhe se kishte jo një, por dy foshnja. "Kur kuptova që isha shtatzënë isha në Portugali dhe po bëja një shou të madh. Në një çast ulem ta bëj grimin dhe ndiej

sikur kisha një flutur në stomak. Menjëherë më shkoi në mendje që mund të isha shtatzënë, sikur e ndjeva. Shkova te doktori dhe bëra kontrollet e nevojshme, megjithëse barku im ishte shumë i sheshtë. Doktori më bëri eko dhe më tha: 'E shikon atë që duket si një bizele e vogël? Është fëmija yt. E shikon atë tjetrën dhe ai është fëmija yt'. Isha e shokuar, por shumë e lumtur. Po qeshja si e çmendur", ka thënë Lopez.




Rita Ora nis turneun e saj në Evropë dhe Azi

Këngëtarja me famë botërore, Rita Ora, ka nisur turneun në Evropë dhe Azi. Tetorin e kaluar Rita njoftoi për datat e turneve që

do të kishte nga 1 marsi deri më 29 maj 2019. Në profilin e vet në "Instagram" ajo ka ndarë disa fotografi ku shfaqet mjaft e emocionuar.

Chris Browni në lidhje me modeluesen Indya Marie



Chris Brown e ka një të dashur të re. "Page Six" ka raportuar se 29-vjeçari Brown dhe modeluesja 25-vjeçare Indya Marie janë në lidhje dashurie. Çifti, që janë përfolur shumë në vitin 2015 kur

Karrueche Tran ishte ndarë me të, së fundmi kanë ringjallur dashurinë e tyre në xhirimet e videoklipit të këngës "Type a Way" që është bashkëpunim i reperit dhe Eric Bellinger.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"



TEL: 045 82 82 82

Feronikeli - Trepça '89, finalja e Kupës

Feronikeli dhe Trepça '89 janë konfirmuar si finalist të Kupës së Kosovës. Skuadra që do të rrëmbejë këtë trofe e fiton të drejtën për të marrë pjesë në Ligën e Evropës, kurse finalja zhvillohet më 25-26 maj



"Epoka e re"

PRISHTINË, 1 MAJ - Skuadra e Feronikelit është treguar e fortë për Ballkanin edhe në ndeshjen e dytë gjysmëfinale në Digitalb Kupën e Kosovës në futboll ka shënuar fitore. "Nikli" e mposhti me rezultat 2-0 në stadiumin "Rexhep Rexhepi" skuadrën e drejtuar nga Gani Sejdiu. Liderja e IPKO Superligës, Feronikeli kaloi në epërsi në minutën e 17-të, kur kapiteni Lapidar Lladrovi realizoi për 1-0. Rezultatit final 2-0 e vulosi tetë minuta para fundit të ndeshjes, Artur Magani. Në këtë mënyrë skuadra nga Drenasi që kishte fituar ndeshjen e parë në Suharekë (1-2), është afruar shumë për të dalë në

arenën ndërkombëtare, pasi përveç që arriti në finale të Kupës është edhe lidere e elitës dhe mund të shpallet kampion. Finalistja e dytë është skuadra e Trepçës '89, e cila posi humbje të mërkurën në ndeshjen kthyesë si vendas nga Vëllanzimi (0-1), por rezultati i ndeshjes së parë të

zhvilluar në Gjakovë (0-4), ishte vendimtar për kalim në finale. Golin e vetëm në ndeshjen e zhvilluar në Mitrovicë e shënoi Fatlum Gashi në pjesën e parë të ndeshjes. Finalja e Kupës së Kosovës në futboll do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" më 25 ose 26 maj.

Angli - Kosovë zhvillohet në "St. Mary's Stadium"

Kombëtarja e Anglisë do të përballet në muajin shtator me Përfaqësuesen e Kosovës në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020". Stadiumi i skuadrës së Southamptonit "St. Mary's Stadium" do të jetë vendi ku anglezët do t'i presin futbollistët e Kosovës. Kosova dhe Anglia bëjnë pjesë në Grupin A së bashku me Çekinë, Malin e Zi dhe Bullgarinë.

SHKURT

Të shtunën mbahet turneu i karatesë "Haki Ibërdemaj"

Federata e Karatesë së Kosovës ka njoftuar se të shtunën do të mbahet turneu memorial ndërkombëtar "Haki Ibërdemaj". Kjo garë është zyrtare dhe organizon FKK-së, kurse organizator teknik është Klubi i Karatesë "Ippon" nga Peja. Përveç klubeve nga Kosova pritet të marrin pjesë edhe klubet nga Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi. Turneu do të mbahet në Palestrën e Sporteve "Karagaçi" në Pejë, duke filluar nga ora 10:00. Kjo garë do të zhvillohet në disiplinën e katave dhe kumite për grupmoshat 7-17 vjeç dhe seniorët (mbi 18 vjeç).

Drita fiton titullin e katërt radhazi në volejball

KV Drita e ka fituar edhe sivjet titullin e kampionit në Superligën e femrave në volejball. Gjilanaset në ndeshjen e tretë të serisë së finaleve të play-off-it mposhtën 3-0 klubin nga kryeqyteti M-Technologie. Drita kishte avantazh psikologjik, pasi i kishte fituar dy ndeshjet paraprake. Në një atmosferë të bukur, në prani të 3 100 spektatorëve në "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan, Drita festoi titullin e katërt radhazi, transmeton "Koha.net". Ndeshja filloi në favor të Dritës, e cila e fitoi setin e parë 25:18. Në periudhën e dytë u vërejt rënie më e madhe në lojën e M-Technologie, e cila u kufizua në vetëm 12 pikë. Seti i tretë e vulosi kampionin e edicionit 2018/19, pasi Drita e fitoi 25:16.

Casillasi pëson sulm në zemër

Portieri i Porto, Iker Casillas është dërguar me urgjencë në spital, pasi ka pësuar një sulm në zemër pas seancës stërvitore të ditës së mërkurë. Ka qenë klubi i Porto që pasdite iu ka komunikuar lajmin medieve në Portugali, pasi spanjoli i është nënshtruar një ndërhyrje për të zhbllokuar arterien e zemrës nga një mpiksje gjaku. Aktualisht 37-vjeçari është shtuar në një spital në Porto dhe është nën vëzhgimin e mjekëve.

Gentian Mezani e ka besimin e Gjilanit

Skuadra e Gjilanit ka konfirmuar nëpërmjet një njoftimi për medie se trajneri aktual, Gentian Mezani, e ka besimin e plotë të kryesisë së klubit. Trajneri nga Shqipëria do të vazhdojë ta drejtojë skuadrën e Gjilanit edhe në të ardhmen. "SC Gjilani informon publikun se pas shkrimeve të fundit që po qarkullojnë nëpër medie dhe gazetat tona, kinse në fundin e sezonit trajneri i ardhur javë më parë, Gentian Mezani, do të largohet nga klubi dhe t'ia lërë postin e kryetrajnerit dikujt tjetër. Këto informata janë të pavërteta dhe nuk qëndrojnë. Kryetrajneri i klubit, Gentian Mezani, e ka besimin dhe mbështetjen e plotë të klubit. Kjo nënkupton se spekulimet e bëra nëpër mediumet tona janë për emra të përveçëm dhe për interesa të personave të caktuar, ndaj me anë të kësaj komunikate duam t'i hedhim poshtë informatat e publikuara nga disa medie", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

Sot fillon seria finale e 'play-off'-it në basketboll

PRISHTINË, 1 MAJ - Sot (e enjte) me fillim nga ora 19:00 në palestrën e vogël të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë do të zhvillohet ndeshja e parë finale e "play-off"-it në Superligën e Kosovës ndërmjet Z Mobile Prishtinës dhe

Rahovecit. Rahoveci në gjysmëfinale triumfoi me seri 3-0 kundër Golden Eagle Yllit, kurse Z Mobile Prishtina me të njëjtin rezultat në seri e mposhti KB Bashkimin. Z Mobile Prishtina i ka fituar të gjitha ndeshjet e edicionit të rreg-

ullt, ndërsa kishte mposhtur Rahovecin në finale të Kupës së Kosovës, garë në të cilën, po ashtu, nuk kishte disfatë. Kampion i Superligës së Kosovës do të shpallet ekipi që i pari arrin tri fitore. Finalja e "play-off"-it zhvillohet

sipas formatit vajtje-ardhje. Përparësinë e terrenit vendës e ka ekipi që ka qenë më mirë i radhitur në edicionin e rregullt dhe luan si vendës në ndeshjen e parë dhe të tretë dhe në ndeshjen eventuale pestë.



Marquezi: Koha për hakmarrje, nuk ka më gabime

Madrid, 1 maj - Botërori 2019 në Moto GP do të nisë këtë fundjavë etapën e tij të parë në "kontinentin e vjetër", në pistën spanjolle të Jerezit. Pas rrëzimit tri javë më parë në Teksas, kampioni i botës në fuqi, Marc

Marquez, u shpreh se në shtëpinë e tij nuk do të ketë më vend për gabime. Objektivi i tij i vetëm është fitorja dhe festa me tifozët. "Jerezi është gjithnjë një garë speciale, pasi është e para në Evropë dhe dua ta fitoj. Për

më tepër që aty kam gjithnjë mbështetjen e shumë tifozëve spanjollë. Nuk dua t'i zhgënjej dhe nuk do të dështoj. Në Teksas bëra një gabim idiot, që nuk do të përsëritet më", ka thënë Marquezi. "Unë synoj fitoren,

ndërsa kryesimi mund të vijë edhe gradualisht, nga gara në garë. Në Jerez vij për t'u hakmarrë pas rrëzimit në Teksas. Do të shfrytëzoj në maksimum çdo pjesë të pistës për të fituar", ka deklaruar Marquezi.



Arsenali kërkon fitore ndaj Valencias

LONDËR, 1 MAJ - Arsenali sonte (e enjte) përballet me Valencian në gjysmëfinale të Ligës së Evropës, me shpresën që do ta përmirësojë formën që ka në ligë, ku nga pesë ndeshjet e fundit është mposhtur plot katër herë. Rezultatet e dobëta në këto ndeshje kanë bërë që Arsenali i dyshes shqiptarë Granit Xhaka e Shkodran Mustafi t'i rrezikojë shanset për të siguruar një vend që e dërgon në Ligën e Kampionëve dhe shanset më të mira për t'u kualifikuar në garën më të fortë në botë i ka nëse triumfon në Ligën e Evropës. Ashtu sikurse Arsenali, edhe Valencia është në garë të rreptë për një pozitë që e dërgon në Ligën e Kampionëve me Getafen, Sevillën dhe Bilbaon. Deri në këtë fazë skuadra spanjolle e ka eliminuar Villarrealin, Krasnodarin dhe Celticun, kurse anglezët eliminuan Napolin, Rennesin dhe Bate Borisovin. Nacho Monreal është i gatshëm për këtë ndeshje sikurse edhe Mesut Ozil, kurse Aaron Ramsey që do të transferohet në Juventus po lihet pas dore. Mungesat kryesore do të jenë Suarez, Holding, Bellerin dhe Welbeck.

Sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër gjysmëfinale në mes të



Eintracht Frankfurtit dhe Chelsea. Skuadra gjermane Eintracht Frankfurt në çerekfinale e eliminoi Benficën ani pse ndeshjen e parë e kishte humbur

4-2, por në ndeshjen e dytë fitoi me rezultat 2-0. Ndërsa Chelsea e siguroi kualifikimin në gjysmëfinale pasi e mposhti Slavia Prague me rezultat të përgjithshëm 5-3.

Golden State, 'leksion' Houstonit

OAKLAND, 1 MAJ - Golden State i ka shfrytëzuar më së miri dy ndeshjet e para gjysmëfinale të luajtura në fushën e saj, duke i fituar të dyja. Kampionët e Warriorsit e mposhtën 115-109 Houstonin në takimin e dytë gjysmëfinale në Konferencën e Perëndimit, duke udhëhequr 2-0 serinë e ndeshjeve. Një përballje në përgjithësi e ekuilibruar, por që Golden State dominoi gjatë gjithë kohës. Vendësit patën vazhdimisht një epërsi prej 10-15 pikësh, duke qenë gjithnjë në epërsi. Të pestë titullarët e Warriorsit realizuan mbi 15 pikë, me të zakonshmin Kevin Durant që ishte shënuesi më i mirë me 29 pikë. Edhe James Harden realizoi 29 pikë për Houstonin, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Tashmë ekipi teksan do të luajë në fushën e tij dy takimet e radhës, me shpresën që të fitojë dhe rihapë kualifikimin. Në Lindje, skuadra e Milwaukee fitoi 123-102 ndaj Bostonit, duke barazuar 1-1 serinë e ndeshjeve. Një ndeshje me dy pamje, e ekuilibruar dhe me rivalitet në të parën, me barazime



të shpeshta. Në të dytën erdhi shkëputja e Bucksit me Antetokounmpon që bëri difer-

encën në parket, duke realizuar 29 pikë e 10 rebounde, mbështetur edhe nga Middletoni me 28 pikë.

KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Milwaukee - Boston	123-102	(1-1)
Toronto - Philadelphia		(1-1)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Golden State - Houston	115-109	(2-0)
Portland - Denver		(0-1)

SHKURT

Interi interesohet për Hysajn dhe Danilon

Krahët e mbrojtjes tek Interi në vitet e fundit kanë qenë pika e dobët që skuadra zikaltër ka vuajtur më shumë. Pas ikjes së Zanettit dhe Maiconit, Interi nuk ka gjetur dot lojtarë të besueshëm dhe që ta nxjerrin skuadrën përpara. Këtë verë, Spalletti, nëse qëndron, do të jetë patjetër një mbrojtës krahu i djathtë. Përveç Danilos së Manchester City, Spalletti kërkon edhe Hysajn. Sipas asaj që raporton "Fcinterneës.it", trajneri i zikaltërve është i bindur për shqiptarin, pasi Martusielo, ndihmësi i tij, i jep garanci teknike. Ky i fundit e ka njohur Hysajn të Empoli dhe i ka mbushur mendjen Spallettit për ta transferuar mbrojtësin shqiptar në Milano gjatë verës.

Përfundon sezoni për Silvan

Pas disfatës së radhës me Montpellierin, kampionët e PSG pësojnë një tjetër humbje. Është kapiteni Thiago Silva i cili duket se ka mbyllur para kohe sezonin për probleme fizike. 34-vjeçari ka dëmtuar meniskun e gjurit në sfidën me Lille, çka e detyron t'i nënshtrohet një ndërhyrjeje kirurgjikale për të cilën ende nuk ka vendosur. Edhe në rast se do të zgjedhë kurë intensive për dëmtimin, mbrojtësi Thiago Silva nuk do të jetë në dispozicion të Tuchelit deri në fundin e sezonit që mbyllet më 25 maj.

Guardiola refuzoi Juventusin


Drejtuesit e Juventusit e kishin kontaktuar Pep Guardiolen pas eliminimit nga Liga e Kampionëve, por trajneri spanjoll e ka refuzuar ofertën e tyre. Ish-trajneri i Barcelonës dhe Bayern Munchenit preferoi ta vazhdojë punën me skuadrën e Manchester Cityt të paktën edhe për një vit tjetër. Megjithatë, të "Zonja e Vjetër" shpresojnë që në të ardhmen ta angazhojnë Guardiolen në pozitën e trajnerit.

























Van de Beek: Javën e ardhshme mbyllem llogaritë me Tottenhamin

Donny van de Beek ishte lojtari kryesor i Ajaxit në fitoren ndaj Tottenham Hotspurit pasi e shënoi golin e vetëm në ndeshje. Futbollisti 22-vjeçar ka thënë se rezultati nga kjo ndeshje është i mirë për skuadrën holandeze, pasi ndeshja kthyes zhvillohet në Holandë. "Në tridhjetë minutat e para luajtëm shumë mirë. Pas tyre, Tottenhami ndryshoi diçka taktikisht dhe ne patëm probleme. Rezultati 1-0 është 'OK' dhe javën e ardhshme ne duhet ta mbyllem këtë llogari", ka thënë Van de Beek. "Nisja ishte me të vërtetë e mirë, por më pas nuk luajtëm ashtu siç mund të luajmë. Duhet të bëjmë një plan të mirë për ndeshjen e kthimit. Duhet të qëndrojmë shumë të qetë. Nuk e di se çfarë do të bëjë Tottenhami në ndeshjen e dytë, por ne dimë që mund të bëjmë më mirë se kaq dhe duhet të përgatitemi për javën e ardhshme. Tifozët do të na japin një shtysë ekstra. Goli? Ishte fotokopje e atij që i shënova Juves", ka deklaruar Van de Beek.

Pogba i vendosur për transferim në Real

Paul Pogba dëshiron me çdo kusht të transferohet te Real Madridi gjatë verës, raporton "Independent". Mesfushori francez është i shqetësuar për pamundësinë e Manchester Unitedit për të sfiduar për titullin e Ligës Premier. Ai beson se Djajtë e Kuq nuk do të arrijnë ta fitojnë titullin për disa vjet në vijim, prandaj mendon për sfida të reja. Reali është ëndërr e tij, këtë e ka pohuar në një deklaratë të mëhershme, ndërsa tashmë po spekulohet se ai mendon seriozisht që ta vazhdojë karrierën në "Santiago Bernabeu". Pogba nuk dëshiron ta presë projektin rindërtues të Unitedit, duke qenë se nuk beson në suksesin afatshkurtër të tij.



						SHUFRA METALIKE TË LIDHURA SI SKELET NDËRMJET TYRE (sh.shq.)	KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)	SHTËPIZË ME DËRRASA (sh.shq.)	AKTORJA ISMAILI	EPOKA E RE	NDENJËSE E GJATË	ZANORE	PREMTIM SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK (sh.shq.)	ASOCIAZIONE NAZIONALE ALOPECIA AREATA	CEREMONI FETARE	EDITA SOPJANI
						AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE JESSICA				LOKAL NATE ME PROGRAM ARTISTIK PIKË (ang.)						
						SHTET NË AFRIKË						KËNGËTARI POTOKU QYTET I MADH NË GJERMANI				
						KUKULLAT									APARTAMENT (sh.shq.)	
						KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE (shqip.)								BASHKËT. RESTORANT, KAFE		
										PEABODY ESSEX MUSEUM THIKE E VOGËL XHEPI ME NJË PRESE			"LOS ANGELES" ANË E MPREHTË E NJË VEGLE			
						SHKENCA MBI MORALIN ZANORE	ZANORE IDRIZ BALAJ		KLUB BASKETBOLLI NË ITALI KUNDËRSHTARI I BOLSHË-VIZMIT RUS							
						KALORËS MESJETAR					NOTË MUZIKORE	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË CIFTËS PORTIERI LIKA				
						AZEM BEJTA LARTËSI QË ARRIN NJË SIPËRFAQE UJI E LIRË		SHTET NË AZI (pashq.) TERËSIA E VUJAVE QË BËHEN NË NJË ARË PËR TË UJITUR					NDESH FUTBOLLISTI GOKHAN (NAPOLI)			
						I SHQUAR, I DALLUAR								NOTË MUZIKORE VËNIA E DATËS NË KALENDAR		
						BANORI I NJË SHTETI SKANDINAV						BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA SKAJ MAGNETIK (sh.pashq.)		TREVISO VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE		
						IRNOSET (bised.)			KOMPOZITORI ITALIAN XHYZEPE			BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN KËNGËTARJA ANILA			ZYRTARIZIM I NJË MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE (sh.shq.)	
						AKTORI AMERIKANE ROBERT DE			KËNGËTARJA ZAHARIA NDODHJE NË NJË VEND TJETËR NË ÇASTIN KUR ËSHTË KRYER NJË KRIM		QË LIDHET ME MONEDHËN FLETORË PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE					
												VARGU I PËRPUTHUR PRONË E VOGËL E SPAHINJVE OTOMAN (shq.)				
						PIKTORI VALLA ZANORE	RAMADAN (perkdh.)	OMANI, LIBERIA E TRAZOJ						KRAHINË NË SHQIPËRI (pashq.) MËNYRË VEPRIMI (shq.)		
						NDJENJË E RESPEKTIT DHE E VLERËSIMIT TË LARTË								I BUKURI (bised.) IRISH FILM INSTITUTE		
						LLOJ BIME NARKOTIKE									EMMA FAZZUOLI REGJISORJA GJONI (shq.)	
						ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE									ZANORE KUNDREJT I FORTI	
						BASHKËT.	"KENIA" VIJA QË SHPIE UJIN NË MULLI		KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.) FUTBOLLISTI ABIDAL		TASH	QESËNDISËS ALBANOLOGIA DURHAM				
												JETA E QETË SHKRONJË GREKE				
						PJESA MË E LARTË E NJË MALI QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT								LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI DUKAT		
						VEÇIMI				SPIKERJA HARADINAJ ZANORE				INITIATIVE GLOBUS EUROPE ZANORE		
						SHKENCËTARI NJUTON (shq.)								UGANDA, TANZANIA		
									E NJËSUAR, E BASHKUAR							



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT


Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore
Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Duke u bazar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149 dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Miratimeve përmes SIMBNJ të pozitive nga DASHC-MAP me datë 25.04.2019, bënë:

SHPALJEN E KONKURISIT PËR KËTË VEND PUNE

Titulli i pozitës: Asistent/e administrativ/e 3
Ref: APK-07/19
Njësia organizative: Drejtorisa Qendrore e Inspektoriatit të Pylltarisë dhe Gjuetisë
Vendi i punës: Prishtinë (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Drejtor i Drejtorisë Qendrore e Inspektoriatit të Pylltarisë dhe Gjuetisë
Kategoria funksionale: Niveli tekniko-administrativ
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 12, Koefficienti 5.5
Lloji i pozitës së punës: E KARRIERËS (e Përhershme),
Kohëzgjatja e periudhës provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryerja e aktiviteteve në pranimin, evidentimin dhe protokollimin e shkresave, kërkesave dhe dokumenteve të tjera zyrtare,
- Udhëheq protokollin e shkurtër dhe atë të zgjeruar,
- Pranon dhe protokollon kërkesa nga palët e ndryshme të ndërlidhura me Drejtorin
- Pranimi dhe dorëzimi i shpenzimeve të Pety cash-it (parasë se imët),
- Shpërndarja e shkresave të ndryshme, vendimet, informatat, proceset etj. dhe mbajtja e evidencës oficiale (takime, porosi, informime etj),
- Plotësimi dhe evidentimi i formularëve mbi ardhjen në punë të stafit në nivel drejtorie .
- Pranimi i postes dhe shpërndarja e sajë brenda APK si dhe mbajtja e evidencës oficiale (takime, porosi, informime).
- Realizimi dhe kryerja e punëve të tjera sipas urdherit të menaxherit të drejtpërdrejtë;

Shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Së paku 3 vite përvojë pune,
- Aftësi për planifikim, vendosjen e prioritetëve në punë dhe vetë iniciativë
- Njohja e kompjuterit dhe aftësia për të përdorur me efekt Microsoft Office, pajisjet tjera të zyrës ,
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës
- Zotësi për punë në mjedis shumëtnikë,
- Aftësi për përgatitje të raporteve, shkresave, kërkesave dhe informatave zyrtare,
- Gatishmëri dhe pedanteri në sistemimin dhe arkivimin e shkresave dhe dokumentacionit zyrtar,
- Korrektësi në mbajtjen e informacioneve dhe mos publikim e tyre pa autorizim
- Të mos jetë i gjykuar për vepër penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të inicituar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale,

Nëse kandidati-ja ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Arsimim i mesëm për administratë, ekonomike apo juridike

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Data e shpalljes së konkursit: 02.05.2019

Data e mbylljes së konkursit: 16.05.2019

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit NR.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore ,zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut të Kosovës).

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8.⁰⁰ deri 16.⁰⁰.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT


Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore
Sektor Ljudskih Resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Na osnovu Zakona za Civilnu Službu Republike Kosova Br.03/L-149, Pravilnika Br.02/2010 za Procedure Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova i Usvajanja izdato preko ISMJALJR,sa pozicija od MJA, dana 25.04.2019, Raspisuje:

KONKURS ZA OVO RADNA MESTA

Naziv pozicije: Administrativni/a asistent/kinja
Ref: AŠK -07/19
Organizaciona Jedinica: DQIPGJ- AŠK
Radno mesto: Priština (1)
Nadzorni Službenik: Direktor DQIPGJ- AŠK
Funksionalna kategorija: Admisitrativni-tehnički nivo
Nivo plate (Koefficient): Grada 12, koefficient 5.5
Vrsta radne pozicije: KARIJERNE pozicije (neodređeno),
Probni vremenski period: Dvanaest (12) meseci

Zadaci i odgovornosti:

- Izvršenje aktivnosti na prijemu, evidentiranje i protokoliranje spisa, zahteva i ostale službene dokumentacije,
- Vodi skraćeni i prošireni protokoll,
- Prima i protokoliša zhteve od raznih stranka vezane sa direktorom
- Prijem i isporuka troškova Pety Cashe (sitnog novca) ,
- Raspoređivanje raznih spisa , odluka, informacija , postupke, itd . i Održavanje službene evidencije (sastanci , isporuke , informacije itd) ,
- Popunjavanje i evidentiranje obrazaca o dolasku na posao osoblja u nivo Direkcije.
- Prijem pošte i njihova raspodela unutar AŠK-a kao i održavanje oficijelne evidencije (sastanke, narudbi, informacije)
- Realizacija i izvršenje drugih poslova po nalogu direktora Direkcije

Ključne veštine, osposobljenost i iskustvo :

- Najmanje tri (3) godine radnog iskustva
- sposobnost za planiranje, ispostavljanje prioriteta u radu i samoinicijativu.
- Poznavanje kompjutera i sposobnost za efektnu upotrebu Microsoft Office, druga kancelarijska oprema ,
- sposobnost upoznavanja jednog od službenog jezika pismeno i usmeno na Republici Kosova
- Sposobnost za rad u multietničkim sredinama,
- sposobnost za pripremu izveštaja, spisa, zhteveva i službenih informacija,
- spremnost i pedantnost u sistematizaciji i arhivisanju spisa i službene dokumentacije,
- korektnost na održanje informacija i njihovo neobjavlivanje bez ovlašćenja,
- da nije kažnjen za krivično delo sa pravosnažnom odlukom i da nije pokrenuta nikakava krivična istraga.

Ako su kandidati radili ili rade u Civilnoj Službi Republike Kosova:

-Dve (2) zadnje godine da ima pozitivne ocene od svog neposrednog rukovodioca,
-Da nije u disciplinskoj proceduri i da nije kažnjen sa disciplinskim merama u tri (3) zadnje godine.

Obrazovna i strucna kvalifikacija za ovu poziciju:

-Srednja obrazovanje za upravno, privrednu ili pravnu

Procedura konkurisanja:

Jeste otvorena i za kandidate van Civilne Službe Kosva.

Datum proglašenja konkursa, 02.05.2019

Datum zključenja konkursa, 16.05.2019

Civilna Kosovka Služba pruža jednake mogućnosti zaposlenja svim državljanima Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica u Kosovo.

Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prave da budu predstavljeni proporcionalno na organima Javne Službe na lokalnim i centralnom nivou ,kao što je naznačeno i čl.11, paragraf 3 Zakona Br/03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova.

Nekompletirane dokumentacije se neće uzeti u obzir.

Dokumenti treba biti fotokopije jer se neće vratiti.

Postupak konkurisanja: Obrazci za konkurisanje se mogu dobiti i dostaviti Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa, kancelarija br.2 pri Agenciji za Šume Kosova, Ul. Zenel Salihu nr. 1/A Priština (iza Muzeja Kosova).

Za dodatne informacije kontaktirajte na telefon br. 038-200-38-482 svakog radnog dana od 8.⁰⁰ do 16.⁰⁰ časova.



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr. 1326/18

GJKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Fahret Vellija, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Adem Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Labinota Vllasaliu, Juriste nga Prishtina, kundër të paditurit Arben Krasniqi nga Prizreni, rruga "Jeronim De Rada", pn., për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 4197.00 euro, me datën 17.04.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Të paditurit Arben (Hajdar) Krasniqi nga Prizreni, rruga "Jeronim De Rada", pn, tani më adresë të panjohur, i **CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokat Avni Berisha nga Prizreni.

II. Përfaqësuesi i përkohshëm në këtë çështje kontestimore i ka të gjitha të drejta dhe obligime të përfaqësuesit ligjor deri sa i padituri Arben Krasniqi të paraqitet pranë kësaj gjykate apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e lajmëron gjykatën për caktimin e kujdestarit.

III. Ky vendim të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", dhe të shpallet në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Labinota Vllasaliu, Juriste nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit Arben (Hajdar) Krasniqi nga Prizreni, rruga "Jeronim De Rada", pn, tani me adresë të panjohur, për shkak të rimbursimit të dëmit.

Gjykata në këtë çështje kontestimore ka caktuar shqyrtimin pregaditor me datën 12.02.2019, duke e ftuar edhe të paditurin Arben Krasniqi, por që nga sletë dërgesat për dorëzim personal është konstatuar se pala është i pa njohur në këtë adresë (pas tentimeve të shumta në adresën e cekur dhe në adresën e tij në komunën e Gjakovës, ku i ati i tij kishte deklaruar se i biri i tij jeton në Prizren). Pasi që as pala paditëse nuk ka mundur të siguroj adresën e saktë të palës së paditur i ka propozuar gjykatës caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

Me qëllim të caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm në këtë çështje kontestimore, gjykata me shkresën e dt. 12.04.2019, ka kërkuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës - Dega në Prizren, që nga radhët e avokatëve të propozojnë një avokat për ta caktuar si përfaqësues të përkohshëm për të paditurin Arben Krasniqi nga Prizreni, pasi që të njëjtit nuk i dihet adresa e saktë, e ndërsa që nuk ka përfaqësues të autorizuar. Oda e Avokatëve të Kosovës - Dega në Prizren me parashtrësën e dt. 15.04.2019, i ka propozuar gjykatës caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për palën e paditur Arben Krasniqi, av. Avni Berisha nga Prizreni.

Duke u bazuar nga të cekurat më lartë, gjykata ka konstatuar se propozimi i palës paditëse për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm është i bazuar, andaj edhe e ka aprovuar të njëjtin. Sipas gjykatës nga të cekurat më lartë janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm ndaj të paditurit Arben Krasniqi, pasi që për një gjë të tillë janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 79 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, andaj, gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

GJKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1326/18 me datë 17.04.2019

B.Profesional
Adem Krasniqi

Gjyqtari
Fahret Vellija

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Certified translation from Albanian language

Republic of Kosovo

C.no.1326/18

BASIC COURT IN PRIZREN, General Department, namely Judge Fahret Vellija, with participation of professional associate Adem Krasniqi, in the legal disputed matter of the claimant Kosovo Insurance Bureau (KIB), seated in Prishtina, represented with Power of Attorney by Labinota Vllasaliu, attorney at law from Prishtina, against the respondent Arben Krasniqi from Prizren, "Jeronim de Rada" street n/n, pertaining to damage reimbursement, the disputed amount Euro 4197.00, on 17.04.2019, rendered the following:

DECISION

- I. A provisional representative is Appointed to the respondent Arben (Hajdar) Krasniqi from Prizren, "Jeronim de Rada" street n/n, current address unknown, attorney at law Avni Berisha from Prizren,
- II. The provisional representative in this disputed matter shall have all the rights and obligations of a legal representative, which he shall exercise before the court until the respondent Arben Krasniqi, or the representative with power of attorney appointed by the responded reports to the court, respectively appointment of a custodian by Custodian Authority.
- III. This Decision shall be published on the "Official Gazette of the Republic of Kosovo", and shall be published on the announcement board of the court.

Reasoning

The claimant, Kosovo Insurance Bureau, seated in Prishtina, represented with power of attorney by, attorney at law Labinota Vllasaliu, filed with this court a claim against the respondent Arben (Hajdar) Krasniqi from Prizren, "Jeronim de Rada" street n/n, current address unknown, pertaining to damage reimbursement.

The court in this contested matter appointed a preliminary hearing on 12.02.2019, summoning also the claimant Arben Krasniqi, however according to delivery slips it is ascertained that the litigant is not living in the same address (after numerous attempts at the said address also at his address in Gjakova, his father stated that his son lives in Prizren). Given that the claimant also failed to obtain the respondent's address, the claimant proposed to the court the appointment of a provisional representative.

26.04.2019
Përkthime
Aulona
Translation / Übersetzung

Translation agency "Aulona"
Sheshi Hasan Prishtina
42000 Vushtrri-Kosovo

Shpend Jashari
Court translator
+386 (0) 49/269 251
+377(0)45/278 858
e-mail: info@perkthime-aulona.com
www.perkthime-aulona.com



Certified translation from Albanian language

In order to appoint a provisional representative in this contested matter, the court filed a submission on 12.04.2019, requesting from Kosovo Bar Association – Prizren branch, to propose a lawyer as a provisional representative for Arben Krasniqi from Prizren, given that his address is unknown, and has no authorized representative. The Kosovo Bar Association – Prizren branch in their submission on 15.04.2019, proposed to the court the appointment of the provisional representative for the respondent Arben Krasniqi, attorney at law Avni Berisha from Prizren.

Based on the foregoing, as per claimant's proposal for appointing a provisional representative, the court after assessing the validity of the proposal as grounded, the proposal was approved. According to the court, based on the foregoing, all legal conditions are met in appointing a provisional representative against the respondent Arben Krasniqi, pursuant to Article 79.1, paragraph 3 of the Law on Contested Procedure (LCP), therefore, the court decided as in the enacting clause of this Decision

BASIC COURT PRIZREN
C.no.1326/18 on 17.04.20

Professional Associate
Adem Krasniqi

Judge
Fahret Vellija
[Stamp and signature]

Legal Remedy: Against this decision an appeal can be filed within a 15-day period, at the Court of Appeals in Prishtina, via this respective court.

26.04.2019
Përkthime
Aulona
Translation / Übersetzung

Translation agency "Aulona"
Sheshi Hasan Prishtina
42000 Vushtrri-Kosovo

Shpend Jashari
Court translator
+386 (0) 49/269 251
+377(0)45/278 858
e-mail: info@perkthime-aulona.com
www.perkthime-aulona.com





Shkolla Mesme e Makinerisë

"Shtjefën Gjeçovi"

Prishtinë 10000 Kosovë, * Rr.Tirana p.n. * Tel. +381 (0)38 613 026

Nr: 48 /3
Dt: 30.04.2019

Në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L-149, neni 12, paragrafi 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, si dhe në bazë të kërkesës me nr. 1445 të dt. 03.10.2018, Shkolla e Mesme e Makinerisë "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë shpall:

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Shkolla e Mesme e Makinerisë "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë*

Paga bruto: 423.85 €

Titulli i vendit të punës: *Zyrtar/e profesional*

(1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: *gjatë (6) mujore*

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të bashkëpunojë ngushtë me administratën e shkollës dhe mësimdhënësit, me partnerët e tjerë të sektorit privat, me asociacionet e bizneseve lokale, divizionin lokal të Unionit Sindikatës të Punës me institucionet e tjera arsimore lokale, etj.
- Të nxjerrë informata të reja që do të jenë në shërbim të përpjekjeve të menaxhmentit dhe bordeve të shkollave për të zhvilluar një material të programit të studimit që bazohet në kërkesën e tregut të punës.
- Ta koordinojë planin për aftësimin e mësimdhënësve dhe përfshirjen e tyre në program e të nivelit të III,IV dhe V-të.
- Ta ndihmojë shkollën - Sh. M. M "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë, në përgatitjen e të dhënave të reja sa i përket studimeve gjurmuese, d.m.th studimit mbi "Hulumtimin mbi zhvillimin e karrierës së nxënësve gjatë shkollimit dhe pas shkollimit të tyre në profilet përkatëse, braktisjes, punësimit pas diplomimit, vetëpunësimit, orientimit në arsimin e lartë etj.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të ligjeve dhe rregullores të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access);
- Diplomë universitare .

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në zyrat e Shkollës së Mesme të Makinerisë "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë rrua Tirana p. n, duke filluar nga ora 8.00 deri në orën 16.00 po ashtu aplikacionet e plotësuar, duhet të dërgohen në këtë adresë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS -MALISHEVË

Zyra e Personelit

Nr.01/536

Më:30/04/2019

Në mbështetjen e Rregullores Nr. 21/2012, për avancimin në karrierë të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURSI BRENDSHËM Për Avancim

Zyra e Kryetarit

L.(Një) Auditor i Brendshëm

Kushtet: Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara: Diplomë universitare, Fakulteti Ekonomik, Juridik

Përvoja e punës : 3 vite përvojë pune profesionale,

Të jetë i certifikuar në fushën e auditimit.

Të ketë njohuri të plotë dhe përvojë të ligjeve dhe procedurave përkatëse,

Koeficienti : 15

Kodi i vendit të punës AU/020

Nr. referencës RN00004788

Mbikëqyrja: Kryetari i Komunës

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për bërjen e auditimeve edhe shërbimeve përkatëse.

-Kryen/udhëheq auditime, përfshirë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat

-Përgatit draft raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bënë intervistën përfundimtare.

- Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e auditimit, dhe dorëzon atë për arkivim

-Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve dhe njësisve organizative.

-Ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët në njësinë e auditimit të brendshëm për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre.

-Ofron këshilla për çështje të auditimit të brendshëm brenda institucionit, sipas nevojës.

Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës.

Kushtet:

-Diploma universitare

-Letërnjoftimi (fotokopje);

-Certifikata e lindjes;

-Certifikata për trajnimet e kryera;

-Dëshmi që nuk është nën hetime

-Vërtetimin e përvojës së punës;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit;

Epoka e re" dhe në tabelë të shpalljeve të KK- Malishevë.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në Zyrën për prirjen e palëve KK- Malishevë.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

**Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.**

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Palma-Com" shpallë të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me nr. 600252275 në Vushtrri.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.




► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

**TOP
PAKO**

-  Komunikim **FALAS**
-  Internet deri në **50Mbps**
-  Televizion Digjital

Për vetëm 17euro

TOP PAKO, PËR TË GJITHË!

TOP Pakot përmbajnë të gjitha shërbimet e nevojshme të komunikimit për biznese të vogla por edhe për familje.

Prej vetëm 17.00€, **10 numra me komunikim FALAS**, PLUS:

- ∞ minuta drejt IPKO-së;
- ∞ SMS;
- Internet në mobil deri në 5GB;
- Televizion digjital dhe Internet deri në **50Mbps**;
- Telefoni Fikse me tarifa standarde;

Për më shumë informata, vizitoni dyqanin më të afërt të IPKO-së.

WWW.IPKO.COM

